Политиката за рамномерен регионален развој во Македонија : цели, предизвици, трендови / [автори Слаѓан Пенеv, Борче Треноvски] = Политика për zhvillimin e barbareтë rajonal në Maqedoni : qëllime, sfida, trende / [autorë Sllagjan Penev, Borçe Trenovski] = Policy on balanced regional development in Macedonia : goals, challenges, trends / [authors Sllagjan Penev, Borçe Trenovski]. - Скопје : Фондација Отворено општество - Македонија = Shkup : Fondacioni shoqëri e hapur - Maqedoni ; = Skopje : Foundation open society - Macedonia, 2017. - 198 стр. : граф. прикази ; 20x20 см

Текст на мак., алб. и англ. јазик. - Фусноти кон текстот. - Библиографија кон деловите

ISBN 978-608-218-247-6


1. Насп. ств. насл. 2. Треноvски, Борче [автор]. - I. Пенеv, Sllagjan види Пенеv, Слаѓан. - II. Пенеv, Sllagjan види Пенеv, Слаѓан
а) Локална самоуправа - Развој - Рамномерно финансирање - Македонија

COBISS.MK-ID 102591242

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen e popullit amerikan me anë të Agjencisë së SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në kuadër të Projektit të USAID për shoqëri qytetare. Përbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk i shpreh qëndrimet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

CONTENTS

ZBULIME TË PËRMBLEDHURA	73
HYRJE	79
PËRSE ËSHTË E NEVOJSHME POLITIKA PËR ZHVILLIM TË BARABARTË RAJONAL - TREGUES STATISTIKOR PËR RAJONET	83
ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL – THEMELIMI LIGJOR	93
KORNIZA 1: POLITIKAT PARAPRAKE PËR ZHVILLIM RAJONAL	94
KORNIZA 2: DATA TË RËNDËSISHME PËR POLITIKËN E ZHBR	101
STRATEGJIA DHE PLANE TË VEPRIMIT PËR ZHVILLIMIN E BARABARTË RAJONAL	105
PLANE VEPRIMI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM TË BARABARTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	108
EFIKASITETI I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË BARABARTË RAJONAL	115
KORNIZA 3: REVIZIONI I REALIZIMIT TË PROGRAMIT PËR ZHBR NGA ANA E ENTIT PËR REVIZION	126
REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	129
LITERATURA E PËRDORUR	131



ZBULIME TË PËRMbledhura

PËRSE ËSHTË E NEVOJSHME POLITIKA E ZHVILLIMIT TË BARABARTË RAJONAL

- Mbi 50% të rritjes natyrale të shtetit del nga Rajoni i Shkupit, ndërsa **rajoni i Shkupit dhe Pollogut përbëjnë diku rreth 90% të rritjes natyrale në vend** – në rajonet tjera kemi një rritje modeste, ndërsa në rajonin e Pellagonisë dhe Lindor kemi edhe ulje.
- Numri i rritur i banorëve si parametër tregon që gjatë 10 viteve të fundit vetëm një pjesë e rajoneve mund të konsiderohen si të avancuar: **Rajoni i Shkupit me mbi 30.000 banorë të rinj, i Pollogut me mbi 10.000 banorë të rinj, Verilindor dhe Juglindor me rritje minimale prej 1.500 deri 2.500 banorë.**
- Krahasimi i të dhënave 2005-2015 tregon që **zvogëlohet pjesa e të rinjve, që më drastike janë shembujt në rajonin e Pollogut, Juglindor dhe Jugperëndimor, ku dallimi në pjesën e popullatës së re në gjithsej popullatën është ndryshuar rreth 5-6%, ndërsa rritje më të madhe të popullatës së moshuar vërehet në rajonin e Shkupit, Juglindor, Lindor dhe Vardarit, mes 2-3%.**
- **Ulje më të madhe të popullatës që është e rrezikuar në kuptimin social ka në Rajonin e Pellagonisë, ku numri i përdoruesve të ndihmës sociale nga viti 2006 deri në vitin 2014 është zvogëluar për rreth tre herë.** Rajoni Verilindor, Vardarit dhe Juglindor për 8 vite më tepër se dyfish kanë zvogëluar numrin e përdoruesve të ndihmës sociale, ndërsa ai Jugperëndimor dhe Lindor kanë zvogëluar pothuaj se dyfish numrin e përdoruesve të ndihmës sociale në krahasim me vitin 2006.
- Shpërndarja e papunësisë sipas rajoneve, ndonëse e zvogëluar në nivel të ultë, shpie në konkluzion që sërisht mbeten dallime të mëdha, që më tutje duhet të jenë bazë për masa dhe aktivitete të ndryshme nëpër rajone të caktuara – **në disa rajone si Verilindor, papunësia në vitin 2015 është më e madhe për pothuaj se 16% ndërsa në atë Jugperëndimor 7% në krahasim me mesataren në shtet.**


- **Rajoni i Shkupit, (ku jetojnë 1/3 e popullatës në vend) krijon madje 43% të PBB kombëtar. Nga kjo, të dhënat për PBB për banor për rajonet dominon Rajoni i Shkupit që ka dy herë e gjysmë PBB më të madhe për kokë banor nga Rajoni Verilindor, që është rajoni më pak i zhvilluar. Vetëm edhe rajoni Juglindor dhe i Vardarit kanë PBB më të lartë për banorë nga mesatarja. Ky është një sinjal që duhet një politikë të domosdoshme dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të barabartë rajonal që në afatin e mesëm mund të jep efekte pozitive.**
- **Rajoni i Shkupit vazhdimisht ka pjesë prej rreth 37-38% të numrit të plotë subjekteve aktive, ai i Pellagonisë rreth 11-12% dhe Juglindor rreth 10%. Përparim pak të theksuar ka Rajoni i Pollogut, pjesa e të cilës rritet prej 9.6% në 2008 në 10.8% në vitin 2015, duke e arritur Rajonin Jugperëndimor në vendin e tretë në lidhje me këtë tregues për zhvillimin rajonal.**
- **Nga krahasimi sipas numrit të punësuarve del që Rajoni Juglindor, Pellagonisë dhe Pollogut në vitin 2015 kanë pasur më pak kompani që kanë punësuar mbi 250 persona, ndërsa ai Juglindor dhe i Pellagonisë kanë pasur më pak kompani që kanë punuar mes 50 dhe 249 persona.**
- **Analiza e pjesës së rajoneve nga gjithsej investimet e plota në mjete themelore tregon një të dhënë shqetësuese që më shumë se gjysma e investimeve gjenden në rajonin më të zhvilluar dhe që rajoni më i pazhvilluar (Verilindor) pothuaj nuk merr asnjë prej investimeve.**
- **Vlera e punëve të kryera ndërtimore tregon që ndonëse në vitin 2007 Rajoni i Pollogut ka qenë vendi kryesor i “ndërtimit” në vend, me pothuaj se një të tretën e vlerës së plotë të punëve të kryera ndërtimore në vitin 2015. Rajoni i Pollogut është i parafundit sipas vlerës së punëve ndërtimore, para Juglindor, që vazhdimisht gjendet në pjesën e poshtme të renditjes së rajoneve sipas këtij parametri. Më pak, gjatë 9 viteve të fundit, ndërtohet në Rajonin Verilindor, që përveç në vitin 2015, në gjitha vitet tjera është në vendin e fundit sipas vlerës së punëve të kryera ndërtimore.**
- **Gjatë 3 viteve të fundit, njësitë e vetëqeverisjes lokale nga Rajoni i Shkupit, përfshirë edhe Qytetin e Shkupit kanë realizuar 37.8% prej gjithsej të ardhurave të NJVL në Maqedoni. Më pak të ardhura kanë realizuar komunat nga Rajoni i Vardarit (7%) dhe të Rajonit Verilindor (7.1%). Vijnë komunat nga Rajoni Juglindor (8.3%), Lindor (8.6%), Jugperëndimor (9.3%), Pellagonisë (10.6%) dhe Pollogut (11.2%).**
- **Të dhënat e fundit për përqindjen e shpërndarjes rajonale të PBB, që e publikon Enti për Statistikë, ka të bëjë me vitin 2013 dhe sipas metodologjisë së tyre ajo ka qenë 29.0% që është zvogëlim në lidhje me vitin 2012 për 0.1%. Zvogëlimi i kësaj përqindjeje shënon barazi më të madhe në zhvillimin rajoneve.**

EFIKASITETI I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË BARABARTË RAJONAL

- Për nxitje të ZHBR nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, në vit duhet të **ndahen mjete në shumë prej së paku 1% të produktit të brendshëm bruto**. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Byroja për Zhvillim Rajonal më tutje në bazë të klasifikimit të zhvillimit të rajoneve duhet të transferojnë një përqindje përkatëse nga këto mjete të secilit prej rajoneve. **Megjithatë, me çdo buxhet të ri, rebalanc të buxhetit dhe llogari përfundimtare të buxhetit të RM, si dhe çdo plan i ri i aksionit për zbatimin e strategjisë për ZHBR del që përkundër kësaj kornize ligjore, Qeveria ka metodologji tjetër në bazë të cilës e kalkulon përqindjen nga PBB që investohen në ZHBR.**
- Fillimet e realizimit të **Ligjit dhe politikave për ZHBR janë përballur me shumë vonesa të zbatimit të komponentëve kryesore, që dukshëm ka ndikuar mbi efikasitetin e gjithë procesit dhe politikës.**
- Dallim i lartë në zhvillim të rajoneve planore në Maqedoni vërehet edhe nga krahasimi i indeksit zhvillimor, ekonomik-social dhe demografik, ku **dukshëm vërehet dallimi mes Rajonit të Shkupit nga njëra anë dhe rajonet tjera nga ana tjetër, veçanërisht në fushën ekonomike-sociale.** Veçanërisht shqetësojnë tendencat në rajonin më dobët të zhvilluar, në të cilin sipas të dhënave të fundit ka papunësi më të lartë prej 43.2%, më tepër përdorues të ndihmës sociale për kokë banorë dhe në të cilën pjesa e investimeve në mjete themelore është rreth 2% për dallim nga ato të plotat në vend.
- Në pjesën më të madhe të raporteve të pavarura për politikën e ZHBR shfaqen të dhëna sipas të cilave mjetet financiare të **Qeverisë për këtë politikë në asnjë vit nuk ka arritur nivelin e preferuar prej 1% të PBB, ndërsa raportet e Qeverisë disponojnë me të dhëna që lëvizin diku rreth 1% deri më 3.25% të PBB, ndonëse me rëndësi është që këto përqindje kanë të bëjnë vetëm me atë që është planifikuar, dhe jo atë që është realizuar, gjegjësisht konfirmuar me të dhëna konkrete nga llogaritë përfundimtare të buxheteve.** Dallimi në dy qasjet është në lidhje me atë nëse mjetet që ndahen nga Buxheti i RM shpërndahen sipas metodologjisë së shpërndarjes së mjeteve për zhvillim rajonal në bazë të shkallës së zhvillimit të rajoneve planore (siç është parashikuar në Ligjin për ZHBR) ose në bazë të ndarjes së plotë për zhvillim rajonal (që është vazhdim i politikave për zhvillim të rajoneve më pak të zhvilluar, që ka ekzistuar para miratimit të Ligjit për ZHBR).

- Me çdo plan të ri të veprimit për zbatimin e strategjisë për zhvillim rajonal zgjerohet numri i ministrive qeveritare dhe agjencive në buxhetet e të cilave përfshihet zhvillimi rajonal i qëllim, **por nuk ka të dhëna që shpërndarja e këtyre mjeteve bëhet sipas prioriteteve për zhvillim rajonal, gjegjësisht sipas shkallës së zhvillimit të rajonit planor** (ndonëse këto pjete alokohen në buxhetet e më tepër ministrive dhe agjencive me parashenjën “rajonale” dhe nuk janë të menaxhuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, por ajo sërish nuk paraqet një përpjekje e caktuar e vendit për mbështetje të zhvillimit rajonal).
- Me këtë qasje në fakt krijuesit e kësaj politike në një segment e kanë kthyer procesin e zhvillimit të rajoneve më pak të zhvilluar në nivel që ka ekzistuar edhe para miratimit të ligjit dhe strategjisë për ZHBR. Pikërisht **metodologjia për nxitjen e zhvillimit të rajoneve në përpjesëtim me shkallën e mungesës së zhvillimit të tyre ishte dallimi i ri specifik në lidhje me politikën paraprake**, për të cilën bartësit e politikës së re kanë pohuar që ka qenë “mono-centrik”.
- Ende **nuk është vendosur një sistem informativ që duhet të përmbajë të dhëna të përditësuar dhe besueshme në lidhje me shkallën e zhvillimit sipas rajoneve, prej të cilëve varet shpërndarja procentuale e mjeteve të Buxhetit të RM sipas rajoneve** për ZHBR.
- Në asnjë prej planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal **nuk prezantohen përqindjes sipas metodologjisë që e parashikon ligjin dhe strategjinë për ZHBR dhe të cilët në periudhën prej 2008 deri 2015 kanë qenë mes 0.002 dhe 03% nga PBB.**
- Nga analiza e të dhënave në dispozicion fitohet përshtypja që mjetet e parashikuar për zbatimin e politikës për ZHBR **gradualisht zhduken gjatë procesit të menaxhimit publik financiar gjatë “alokimit”, “aprovimit” dhe “pagesës” së mjeteve nga Buxheti i RM-së nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale.** Ashtu, për shembull, **mesatarja në përpjesëtimin e mjeteve të planifikuar për alokim dhe mjete të alokuara nga Buxheti i RM për realizimin nëpërmjet MVL në periudhën 2009-2012 është vetëm 45%**, ndërsa mesatarja në këto tre vite të përdorimit të mjeteve në lidhje me mjetet e planifikuar në Planin e Veprimit 2009-2012 është më i ultë dhe është madje edhe **më pak (29%)**. Megjithatë, krahasimi i treguesit të mjeteve të paguara/shfrytëzuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të realizuar nëpërmjet MVL dhe Byrosë në lidhje me ato të planifikuarat në planin e veprimit vërehet që kjo përqindje në 2013-2015 është rritur dhe paraqet 53%, në krahasim me periudhën 2009-2012 kur i njëjti ka qenë 29%.

- Për shkak të shumës së pamjaftueshme të mjeteve që ndahen nga Buxheti i RM për zhvillim rajonal, si dhe trendi i zvogëlimit të mjeteve të planifikuar me rebalancin e buxhetit, **nuk është arritur efektivitet i mjaftueshëm i realizimit të politikës për ZHBR.**
- Nga të dhënat e prezantuar në planet e veprimit vërehet një përparim modest ndaj realizimit të synimeve të caktuara, **megjithatë ende mbetet një hapësirë e madhe për përmirësim në fushën e: zvogëlimit të papunësisë, dallimi në PBB për kokë banor në krahasim me BE dhe mes rajoneve, rritja e popullatës në rajonet dhe kohëzgjatja e pritur e jetës.**
- Disa prej parametrave sipas të cilave paraprakisht kemi analizuar zhvillimin rajonal tregojnë tendenca negative për politikën e ZHBR (fillimisht të dhënat për mplakjen e popullatës dhe investimet e plota në mjete themelore), **ndërsa disa prej të dhënave japin një pikë shpresë që është e mundshme përmirësimi i pjesshëm i pasojave nga investimi dominues shumëvjeçar në zhvillimin e kryeqytetit të vendit (të dhënat për subjektet aktive afariste dhe për punët e kryera ndërtime).**



HYRJE

Zhvillimi rajonal si koncept nënkupton mbështetje të vazhdueshme financiare nga ana e shtetit dhe shkallë të lartë të koordinimit të mbështetjes mes ministrive, donatorëve dhe palëve të interesuara në nivelin rajonal dhe lokal. Politika rajonale është një prej shenjave më të dalluara të funksionimit të Bashkimit Evropian, ku kjo politikë quhet edhe politikë e kohezionit¹ që ka për qëllim të përmirësojë mirëqenien e rajoneve në Evropë dhe uljen e pabarazive rajonale.

Me politikën për zhvillim rajonal në Republikën e Maqedonisë është bërë një tentim për përputhje me prioritetet e politikës së BE për kohezion ekonomik-social dhe prioritetet e identifikuara në Strategjinë e Lisbonës për BE². Kjo përputhje është bërë me qëllim të nxitjes së zhvillimit të rajoneve planore sipas udhëzimeve të përcaktuara nga BE dhe të veprohet në kuptim të arritjes së kapaciteteve të rajoneve planore dhe njësive të vetëqeverisjes lokale për përdorim të komponentëve përkatëse të IPA fondeve të BE-së në dispozicion.

Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal që në Republikën e Maqedonisë ishte miratuar në vitin 2007 ishte një prej hapave më të rëndësishme për të prezantuar një qasje të re në lidhje me problemin që me dekada trajtoheshe si mungesë e zhvillimit të rajoneve specifike, rajone të pazhvilluara, etj.³ Në këtë ligj në mënyrë eksplicite përcaktohet politika e nxitjes së zhvillimit të barabartë rajonal si sistem i qëllimeve, instrumente dhe masa të drejtuara për uljen e mangësive rajonale dhe realizimin e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë.

Nevoja për këtë ligj dhe për këtë politikë arsyetohej me mungesën shumëvjeçare të politikës për zhvillim rajonal dhe përqendrimin e vullshëm të pjesës më të madhe të aktiviteteve ekonomike në Rajonin e Shkupit dhe pjesërisht zhvillimin e qendrave më të mëdha urbane në rajonet tjera planore. Përqendrimi i lartë i popullatës dhe aktiviteteve ekonomike në qendrat urbane pasqyrohet në mënyrë negative mbi dimensionin social dhe hapësinor të zhvillimit sepse rezulton me shuarjen e një pjese

1 Për këtë politikë ndahet më shumë se një e treta e Buxhetit të BE.


2 Më tepër informacione për Strategjinë e Lisbonës në http://www.consilium.europa.eu/en/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/00100-r1.en0.htm


3 Në lidhje me politikën për ndihmë të rajoneve të pazhvilluara, më tepër informacione në kornizën 1 "Politika paraprake për zhvillim rajonal"

të madhe të lagjeve rurale, dhe në kohën e njëjtë krijon probleme në funksionimin e qendrave urbane për shkak të mungesës së infrastrukturës përkatëse teknike dhe sociale për përqendrimin e lartë të popullatës. Nga kjo, paraqiten shumë mangësi në aspektin ekonomik, social dhe tjera të zhvillimit si në mes ashtu edhe në kuadër të rajoneve planore që paraqesin një bazë nisjeje planore të zhvillimit rajonal.

Të gjitha dokumentet strategjike, programore dhe planore që vijuan pas miratimit të ligjit, si dhe projektet e zbatuara për zbatimin e politikës për zhvillimin e barabartë rajonal (në tekstin më tutje: ZHBR) gjatë pothuaj dhjetë viteve të fundit kanë shfaqur *shumë mangësi dhe probleme* në funksionimin e politikës, me shumë vonesa dhe shkelje të afateve ligjore.

Në këtë analizë në fillim do të mundohemi në bazë të dhënave statistikore në dispozicion të krijojmë një pasqyrë të shpërndarjes së zhvillimit rajonal dhe cilat janë tendencat nëpër rajonet e ndryshme. Kjo më tutje do të jetë bazë për të shikuar nga njëra anë nëse kemi parashikime pozitive për rajonet, të zbulojmë sfidat kryesore të politikës për zhvillim rajonal ndërsa nga ana tjetër kjo është një test sa ka qenë efikase kjo politikë me kalimin e viteve. Më tutje fokusi ynë do të drejtohet në themelimin ligjor të politikës për zhvillim të barabartë rajonal në dekadën që kaloi, të përcaktojmë çfarë ka qenë e planifikuar dhe realizuar, të tregojmë për dobësitë dhe lëshimet në zbatimin e politikës, si dhe të japim rekomandime për zbatimin e këtyre politikave.





PËRSE ËSHTË E NEVOJSHME POLITIKA PËR ZHVILLIM TË BARABARTË RAJONAL - TREGUES STATISTIKOR PËR RAJONET

Në publikimet e fundit të edicionit “Maqedonia në Numra” Enti Shtetëror i Statistikës publikon të dhëna për shpërndarjen e PBB rajonal. Vlera e saj do të ishte zero kur PBB për banor në gjithë vendin do të ishte identik, ndërsa rritet kur rritet dallimi mes PBB për banor në rajonet dhe PBB mesatar për banor në nivel të vendit. Në publikimin për vitin 2014 ishin prezantuar të dhënat që në vitin 2010 shpërndarja e PBB rajonal ka qenë 31.0%, në vitin 2011, 29.3% ndërsa në vitin 2012 31.5%.⁴ Në publikimin e vitit e ardhshëm, në edicionin “Maqedonia në Numra 2015”, ishin korrigjuar këto të dhëna, ashtu që sipas metodologjisë së re, në vitin 2010 shpërndarja e PBB rajonal ka qenë 28.9% (korrigjim për 2.1%), për vitin 2011 26.5% (korrigjim për 2.8%), ndërsa për vitin 2012 - 29.1% (korrigjim për 2.4%)⁵. Në botimin më të ri për vitin 2016, paraqitet e dhëna se shpërndarja e BPV në vitin 2013 ka qenë 29.0%.⁶

Edhe pse në planet e aksionit dhe dokumentet tjera të qeverisë theksohet se në periudhën pas miratimit të politikave rajonale zhvillimore janë realizuar masa dhe aktivitete për nxitjen e ZHBR, në bazë të cilës është arritur zvogëlim i dallimeve në zhvillim në qytetin e Shkupit dhe rajonet tjera

4 Maqedonia në Numra 2014, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2014

5 Maqedonia në Numra 2015, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2015

6 Maqedonia në Numra 2016, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2016, http://www.stat.gov.mk/Publikacii/MakedonijaVoBrojki2016_mk.pdf

planore⁷, shumë prej treguesve konfirmojnë që dallimet nuk zvogëlohen por për disa rajone edhe më tutje rriten në krahasim nga ajo e Shkupit.

Në vazhdim të analizës ju prezantojmë dhe elaborojmë disa tabela me të dhënave sipas të cilave mund të arrihen disa prej konkluzioneve të përgjithshme për zhvillimin e rajoneve në vitet e fundit, si dhe të arrijmë në konkluzione për nevojat, sfidat dhe efektet e politikës për ZHBR. Pa qëllim të relativizojmë klasifikimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore, që edhe në vitet 2008 dhe 2012, e kanë bërë ekspertë me njohuri të shkëlqyeshme të disiplinave ekonomike, demografike dhe zhvillimore, do të theksojmë disa të dhëna statistikore që tregojnë disa segmente kryesore të zhvillimit të rajoneve ngecin, ndonjëherë edhe në masë drastike, nga tendencat dominuese që janë marrë si vendimtare për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve.

Tabela 1: Veçori themelore të rajoneve planore

Rajoni	Sipërfaqe në km ²	Numri i komunave	Numri i banorëve – 2006	Numri i banorëve – 2015
Republika e Maqedonisë	25.713	80	2.040.228	2.071.278
Vardari	4.042	9	154.230	152.917
Lindor	3.537	11	180.938	176.877
Jugperëndimor	3.340	9	222.385	219.718
Juglindor	2.739	10	171.972	173.552
Pellagonisë	4.717	9	236.088	230.771
Pollogu	2.416	9	310.178	320.299
Verilindor	2.310	6	173.982	176.231
Shkupit	1.812	17	590.455	620.913

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Nëse numri i rritur i banorëve është parametër sipas të cilit do të vlerësohej përparimi në zhvillimin e rajonit, gjatë 10 viteve të fundit, vetëm gjysma e rajoneve mund të konsiderohen si të përparuar relativisht: Rajoni i Shkupit me mbi 30.000 banorë të rinj, i Pollogut me mbi 10.000 banorë të rinj, Verilindor dhe Juglindor me rritje minimale prej 1.500 deri 2.500 banorë. Këto të dhëna, gjithsesi, janë bazë të projektimit të popullsisë, sepse më 14 vite nuk ka regjistrim të popullsisë, dhe një arsye tjetër kufizuese paraqet edhe mungesa e evidencës së plotë dhe saktë për personat që kanë braktisur shtetin. Megjithatë edhe në kuadër të dhënave në dispozicion edhe ky parashikim modest i banorëve sipas rajoneve (ndonëse tek një pjesë prej tyre kemi edhe zvogëlim të vogël) ende është evidentuar dukshëm dallimi mes rajoneve dhe dominimin e përforcuar të Rajonit të Shkupit që ka më tepër se herë banorë në krahasim me rajonet tjera.

Tabela 2: Mplakja e popullsisë sipas rajoneve

	2005			2015		
	Popullsi mbi 65 vjeç, në vjeç, në %	Popullsi nën 15 vjeç, në %	Rritja natyrore	Popullsi mbi 65 vjeç, në %	Popullsi nën 15 vjeç, në %	Rritja natyrore
Maqedoni	11,0	19,2	4,076	13	16,7	2.614
Pellagoni	15,2	16,6	-557	15,7	15,4	-720
Vardari	11,9	17,5	-12	14,1	15,8	-173
Juglindor	10,5	21,1	410	13,2	16,4	50
Jugperëndimor	10,3	20,8	309	11,3	15,4	184
Shkupit	10,6	18,5	2.576	13,7	18,3	2.214
Verilindor	11,3	18,3	221	11,9	17,5	137
Pollogu	8,2	23,3	1.366	9,0	17,0	1.197
Rajoni lindor	11,9	16,7	-237	14,5	14,3	-275

Burimi: Plani Kombëtar i Zhvillimit 2007-2009 dhe Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Analiza e mplakjes së popullatës sipas rajoneve tregon që në gjitha rajonet popullata plaket - zvogëlohet pjesa e të rinjve, që më drastike janë shembujt në rajonin e Pollogut, Juglindor dhe Jugperëndimor, ku dallimi në pjesën e popullatës së re në gjithsej popullatën është ndryshuar rreth 5-6 për qind, ndërsa rritje më të madhe të popullatës së moshuar vërehet në rajonin e Shkupit, Juglindor, Lindor dhe Vardarit, mes 2-3 për qind. Trendët shqetësuese konfirmohen edhe me të dhënat për rritjen natyrore – në gjitha rajonet është zvogëluar rritja natyrore për dallim nga dhjetë vitet më herët, ndërsa nga ana tjetër mbi 50% në shtet i njëjti del nga Rajoni i Shkupit, ndërsa rajoni i Shkupit dhe Pollogut përshijnë diku rreth 90% të rritjes natyrore në shtet.

Tabela 3: Përdorues të ndihmës sociale

	2006	2010	2014	Ndryshim 2006-2014 %
R. e Maqedonisë	249.619	176.431	128.679	- 48,4%
Vardari	14.936	9.183	5.977	- 60%
Lindor	19.228	11.322	9.694	- 49,6%
Jugperëndimor	22.989	16.233	11.615	- 49,5%
Juglindor	14.029	8.058	6.331	- 54,9%
Pellagonisë	31531	14.649	10.811	-65,7%
Pollogu	44694	41.391	25.492	-43%
Verilindor	41685	20.053	16.440	-60,6%
Shkupit	60527	55.542	42.319	-30,1%

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Të gjitha këto tabela (shiko Tabelën Nr. 3) tregojnë një ndryshim të madh të popullatës që është e rrezikuar në kuptimin social ka në Rajonin e Pellagonisë, ku numri i përdoruesve të ndihmës sociale nga viti 2006 deri në vitin 2014 është zvogëluar për rreth tre herë. Rajoni Verilindor, Vardarit dhe Juglindor për 8 vite më tepër se dyfish kanë zvogëluar numrin e përdoruesve të ndihmës sociale, ndërsa ai Jugperëndimor dhe Lindor kanë zvogëluar pothuaj se dyfish numrin e përdoruesve të ndihmës sociale në krahasim me vitin 2006. Pollogu (-43%) dhe Rajoni i Shkupit (-30.1%) kanë gjithashtu një ulje të konsiderueshme të këtij grupi të popullatës së rrezikuar sociale.

Tabela 4: Shkalla e aktivitetit të popullatës në moshë prej 15 vjeçe e më tepër sipas rajoneve, të ndarë në vite

	2009			2012			2015		
	Aktivitet	Të punësuar	Të papunë	Aktivitet	Të punësuar	Të papunë	Aktivitet	Të punësuar	Të papunë
RM	56,7	38,4	32,2	56,5	39	31	57	42,1	26,1
Vardari	58,3	35,2	39,7	59,1	37,9	35,9	60,7	45,8	24,5
Lindor	59,5	49,4	17	61,5	50,1	18,5	62,5	51,6	17,5
Jugperëndimor	55,8	37,5	32,7	56,2	32,4	42,3	54,9	36,2	33,9
Juglindor	69,6	59,6	14,4	70,7	60,9	13,8	68,4	56,9	16,7
Pellagoni	63,8	42,6	33,2	62,8	46,9	25,3	66,3	52,2	21,1
Pollogu	46,1	33,5	27,3	44,5	29,3	34,2	47,1	33,2	29,6
Verilindor	56,9	20	64,8	52,1	24,6	52,8	54	30,6	43,2
Shkupit	54,4	36,2	33,5	55,3	38	31,3	54,4	40,4	25,7

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Shkalla e aktivitetit, punësisë dhe papunësisë së popullatës (shiko Tabelën Nr. 4) tregon që disa trendë pozitive në lidhje me papunësinë dhe popullatën e aftë për punë, veçanërisht në Rajonin Verilindor dhe të Vardarit ku punësimi për 6 vitet është rritur për më tepër se 10 pikë përqindjeje, ndërsa papunësia në kohën e njëjtë është zvogëluar për më tepër se 20, gjegjësisht 15 pikë përqindjeje. Rajoni i Pellagonisë gjithashtu ka tregues pozitiv për këtë periudhë (pothuaj se 10% më tepër të punësuar dhe rreth 12% më pak të papunë). Përkundër këtyre, Rajoni Jugperëndimor, Juglindor dhe Pollogut kanë shënuar ulje të punësisë dhe rritje minimale të papunësisë gjatë këtyre 6 viteve. Megjithatë, Rajoni lindor shënon rritje të punësisë dhe papunësisë. Shpërndarja e papunësisë sipas rajoneve mundëson të arrijmë në konkluzion që e njëjta paraqet një sfidë e madhe për politikën për zhvillim të barabartë rajonal duke marrë parasysh që ajo ndonëse ka ulje modeste në pjesën më të madhe të rajoneve, sërish mbeten dallime të mëdha, që më tutje duhen të jenë bazë për masa të ndryshme dhe aktivitete sipas rajoneve të ndryshme. Në disa rajone si Verilindor, papunësia në

vitin 2015 është më e madhe për pothuaj se 16% ndërsa në atë Jugperëndimor 7% në krahasim me mesataren në shtet.

Tabela 5: PBB sipas rajoneve

2006	PBB (në milion denarë)	Struktura e PBB, RM=100%	PBB, për banor, në denarë	PBB, për banorë, MK=100
R. e Maqedonisë	310,915	100	152.392	100
Vardari	25,498	8.2	165.327	108,5
Lindor	19,913	6.4	110.055	72,2
Jugperëndimor	22,855	7.4	102.774	67,4
Juglindor	23,670	7.6	137.640	90,3
Pellagonisë	35,238	11.3	149.258	97,9
Pollogu	22,658	7.3	73.047	47,9
Verilindor	13,612	4.4	78.240	51,3
Shkupit	147,470	47.4	249.756	163,9
2010	PBB, në milion denarë	Struktura e PBB, RM=100%	PBB, për banor, në denarë	PBB, për banorë, MK=100
R. e Maqedonisë	437.296	100	212.795	100
Vardari	31.249	7,1	203.102	95,4
Lindor	37.850	8,7	210.546	98,9
Jugperëndimor	35.828	8,2	161.492	75,9
Juglindor	39.161	9	226.550	106,5
Pellagonisë	52.923	12,1	226.036	106,2
Pollogu	33.707	7,7	107.074	50,3
Verilindor	20.671	4,7	118.092	55,5
Shkupit	185.906	42,5	308.467	145
2014	PBB, në milion denarë	Struktura e PBB, RM=100%	PBB, për banor, në denarë	PBB, për banorë, MK=100%
R. e Maqedonisë	527.632	100,0	255.206	100,0
Vardari	42.079	8,0	274.404	107,5
Lindor	43.407	8,2	244.272	95,7
Jugperëndimor	41.629	7,9	189.109	74,1
Juglindor	52.775	10,0	304.140	119,2
Pellagonisë	58.412	11,1	251.988	98,7
Pollogu	37.413	7,1	117.284	46,0
Verilindor	26.182	5,0	148.745	58,3
Shkupit	225.734	42,8	366.482	143,6

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

PBB sipas rajoneve është një prej treguesve më relevant për numrin e plotë të rajoneve. Të dhënat për këtë kategori tregojnë që në krahasim me vitin 2006, ka një ulje të pjesës së Rajonit të Shkupit në PBB të plotë të vendit, rritje minimale, por e vazhdueshme për rajonin më pak të zhvilluar, Verilindor, dhe një rritje të sigurt të Rajonit Juglindor që gjatë viteve të fundit vazhdimisht vërehet si PBB për kokë banorë mbi nivelin mesatar të shtetit dhe që pjesë e së cilës në PBB të plotë është rritur nga 7.6% në vitin 2006 në 10% në vitin 2014. Rajoni i Vardarit, Lindor, Jugperëndimor, Pellagonisë dhe Pollogut kanë lëvizje në lidhje me këtë parametër kur do të krahasohen vitet 2006, 2010 dhe 2014. Nëse krahasohet gjendja nga viti 2006 dhe 2014, mund të vërehet që ulja në pjesën e PBB të Rajonit të Shkupit prej 4.6 pikë përqindjeje dhe ulja e rajonit të Pellagonisë, Pollogut dhe Vardarit për 0.2 për qind është “kompensuar” me rritjen e Rajonit Juglindor për 2.4 pikë përqindjeje, me rritjen e Rajonit Lindor për 1.8 pikë përqindjeje, me rritjen e Verilindor për 0.6 pikë përqindjeje dhe me rritjen e Juglindor për 0.5 pikë përqindjeje.

Struktura e PBB sipas rajoneve na jep pasqyrën më të mirë për pabarazinë e zhvillimit sipas rajoneve në Maqedoni – Rajoni i Shkupit (në të cilin jetojnë 1/3 e popullsisë së vendit) krijon madje 42.8% të PBB dhe ka PBB më të lartë për kokë banor nga mesatarja e shtetit, ndërsa vetëm edhe Rajoni Juglindor dhe Vardarit kanë PBB më të lartë për kokë banor nga mesatarja. Rajoni i Pollogut ka nën gjysmën (46%) të PBB për kokë nga mesatarja, ndërsa ai Verilindor rreth 58%, ndërsa Jugperëndimor 74% të mesatares së shtetit. Kjo do të duhet të jetë sinjal për krijuesit dhe zbatuesit e politikës së ZHBR që në këto tre rajone duhet të dedikohet më tepër vëmendje në periudhën më afatshkurtër, sepse këto tre rajone kanë papunësi më të madhe (tabela 4) dhe nëse nuk e arrijnë hapin me rajonet më të zhvilluara mund të mbeten pika të zeza në hartën e rajoneve më të pazhvilluara në Evropë.

Tabela 6: Investime në mjete themelore, në milion denarë

	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej	%
R. e Maqedonisë	100.851	109.219	109.071	119.003	123.549	561.693	100
Vardari	6.621	5.642	5.016	8.179	7.350	32.808	5,8
Lindor	9.078	5.070	5.964	10.462	10.175	40.749	7,3
Jugperëndimor	5.095	4.241	5.352	5.597	9.473	29.758	5,3
Juglindor	7.148	5.355	4.728	6.390	6.940	30.560	5,4
Pellagonisë	7.690	5.765	10.236	10.745	8.329	42.765	7,6
Pollogu	7.105	7.708	9.059	7.558	7.058	38.487	6,9
Verilindor	2.905	1.353	2.645	2.482	2.543	11.927	2,1
Shkupit	55.210	74.086	66.072	67.589	71.681	334.638	59,6

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Të dhënat për investimet në mjetet themelore (shiko Tabelën Nr. 6) tregojnë rezultate më të dobët për politikën e ZHBR. Pjesa e rajoneve në investime e plota tregojnë që më tepër se gjysma (ndonjëherë edhe 70%) e investimeve janë vendosur në rajonin më të zhvilluar dhe që në rajonin më pak të zhvilluar (Verilindor) pothuaj se asgjë nuk investohet, me pjesë konstante prej 3% të investimeve të plota në mjetet themelore.

Tabela 7: Subjekte aktive afariste

	2008	2012	2015
R. e Maqedonisë	63.193	74.424	70.139
Vardari	4.828	5.975	5.470
Lindor	5.299	5.913	5.692
Jugperëndimor	6.484	7.564	7.127
Juglindor	5.503	6.373	5.889
Pellagonisë	7.523	8.468	8.071
Pollogu	6.050	7.285	7.554
Verilindor	3.691	4.283	4.139
Shkupit	23.815	28.563	26.197

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Të dhënat për subjektet aktive afariste (shikoni Tabelën Nr. 7) tregojnë tendenca pozitive në gjitha rajonet nëse merret parasysh numri i plotë i subjekteve të regjistruar. Në lidhje me pjesën e rajonit në numrin e plotë të subjekteve aktive, gjendja është e qetë gjatë viteve, Rajoni i Shkupit vazhdimisht ka pjesë prej rreth 37-38% të numrit të plotë subjekteve aktive, ai i Pellagonisë rreth 11-12% dhe Juglindor rreth 10%. Përparim pak të theksuar ka Rajoni i Pollogut, pjesa e të cilës rritet prej 9.6% në 2008 në 10.8% në vitin 2015, duke e arritur Rajonin Jugperëndimor në vendin e tretë në lidhje me këtë tregues për zhvillimin rajonal. Por, nëse krahasohet numri i të punësuarve del që Rajoni Juglindor, Pellagonisë dhe Pollogut në vitin 2015 kanë pasur më pak kompani që kanë punësuar mbi 250 persona, ndërsa ai Juglindor dhe i Pellagonisë kanë pasur më pak kompani që kanë punuar mes 50 dhe 249 persona.

Tabela 8: Punë ndërtimore të kryera, në mijëra denarë

	2007	%	2010	2013	2015	%
R. e Maqedonisë	22.258.526	100	25.025.816	37.750.104	41.209.648	100
Vardari	942.246	4,2	1.184.760	4.193.177	4.158.385	10,1
Lindor	811.578	3,6	1.839.722	1.614.495	4.176.346	10,1
Jugperëndimor	3.140.527	14,1	2.378.635	2.754.445	5.386.551	13,1
Juglindor	1.756.640	7,9	2.195.692	2.127.929	1.421.037	3,4
Pellagonisë	1.635.286	7,3	2.475.012	5.107.026	4.788.052	11,6
Pollogu	7.470.033	33,6	5.068.724	4.352.401	2.555.666	6,2
Verilindor	288.531	1,3	633.970	1.073.275	4.549.361	11
Shkupit	6.213.685	27,9	9.249.301	16.527.356	14.174.250	34,4

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë

Vlera e punëve të kryera ndërtimore është gjithashtu një parametër i rëndësishëm për krahasim të zhvillimit të rajoneve, ndonëse në lidhje me këtë komponentë vërejmë disa lëvizje të mëdha. Nëse në vitin 2007 Rajoni i Pollogut ka qenë vendi kryesor i “ndërtimit” në vend, me pothuaj se një të tretën ë vlerës së plotë të punëve të kryera ndërtimore (ndërsa pesë vitet vijuese është rajoni i dytë, pas atij të Shkupit) në vitin 2015. Rajoni i Pollogut është i parafundit sipas vlerës së punëve ndërtimore, para Juglindor, që vazhdimisht gjendet në pjesën e poshtme të renditjes së rajoneve sipas këtij parametri. Rajoni i Pellagonisë dhe Jugperëndimor në këto 9 vitet janë mes rajoneve me vlerë më të madhe të punëve ndërtimore, ndërsa i Vardarit dhe Lindor janë shpesh në pjesën e vlerës më të vogël të punëve të kryera ndërtimore. Më pak gjatë 9 viteve të fundit ndërtohet në Rajonin Verilindor, që përveç në vitin 2015, në gjitha vitet tjera është në vendin e fundit sipas vlerës së punës së kryera ndërtimore.


Tabela 9: Të ardhura dhe shpenzime të plota të komunave, në mijëra denarë

	2013		2014		2015	
	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime
R. e						
Maqedonisë	28.136.999	27.892.548	28.253.055	27.732.155	30.132.499	29.251.474
Vardari	1.899.154	1.890.153	2.042.024	2.005.454	2.156.996	2.096.797
Lindor	2.352.714	2.328.043	2.532.933	2.452.526	2.536.120	2.509.826
Jugperëndimor	2.648.840	2.603.786	2.624.033	2.594.441	2.793.562	2.759.446
Juglindor	2.242.866	2.232.939	2.408.557	2.337.640	2.543.821	2.483.198
Pellagonisë	3.024.743	3.007.182	3.006.346	2.958.032	3.111.393	3.058.696
Pollogu	3.108.638	3.072.581	3.270.648	3.207.566	3.353.193	3.326.890
Verilindor	2.031.806	2.023.025	2.113.130	2.084.340	2.028.421	2.009.295
Shkupit	10.816.665	10.734.839	10.255.383	10.092.156	11.608.994	11.007.326

Burimi: sobranie.mk

Në lidhje me shpenzimet e plota të komunave, gjatë 3 viteve të fundit, njësitë e vetëqeverisjes lokale nga Rajoni i Shkupit, përfshirë edhe Qytetin e Shkupit kanë realizuar 37.8% prej gjithsej të ardhurave të NJVL në Maqedoni. Më pak të ardhura kanë realizuar komunat nga Rajoni i Vardarit (7%) dhe të Rajonit Verilindor (7.1%). Vijnë komunat nga Rajoni Juglindor (8.3%), Lindor (8.6%), Jugperëndimor (9.3%), Pellagonisë (10.6%) dhe Pollogut (11.2%).

Të dhënat më lartë ishin prezantuar dhe elaboruar me qëllim të bëhen krahasime të zhvillimit të tetë rajoneve planore sipas disa prej parametrave më të rëndësishme për zhvillimin e tyre. Nëse kalohet në analizë më të hollësishme të komponentëve të disa prej këtyre të dhënave dhe kur të njëjtat do të krahasoheshin në kornizë më të gjatë kohore, do të fitohej një pasqyrë më të plotë të anëve të dobëta dhe të fuqishme të cilit prej rajoneve në lidhje me potencialet për zhvillim. Disa prej parametrave sipas të cilave paraprakisht kemi analizuar zhvillimin rajonal tregojnë tendenca negative për politikën e ZHBR (fillimisht të dhënat për mplakjen e popullatës dhe investimet e plota në mjete themelore), ndërsa disa prej të dhënave japin një pikë shpresë që është e mundshme përmirësimi i pjesës nga investimi dominues shumëvjeçar në zhvillimin e kryeqytetit të vendit (të dhënat për subjektet aktive afariste dhe për punët e kryera ndërtimore).



ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL – THEMELIMI LIGJOR

Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal ishte miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e zhvilluar më 15 maj 2007. Me atë janë theksuar qëllimet, parimet dhe bartësit e politikave për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, planifikimin e zhvillimit rajonal, financimin dhe shpërndarjen e mjeteve për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal, ndjekja dhe notimi i vlerësimit të dokumenteve planore dhe projekte dhe çështje tjera të lidhur me zhvillimin rajonal.⁸

Me këtë ligj, zhvillimi rajonal ishte përcaktuar si një proces për identifikimin, nxitjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e potencialeve zhvillimore të rajoneve planore dhe rajonet me nevoja specifike zhvillimore, ndërsa politika për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

si sistem i qëllimeve, instrumente dhe masa të drejtuara për uljen e mangësive rajonale dh realizimin e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë. Rajoni planor është përcaktuar si një njëri funksionale-territoriale e caktuar për nevojat e planifikimit të zhvillimit dhe realizimit të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

Si qëllime kryesore të politikës për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal në këtë ligj janë theksuar:

- zhvillim i barabartë dhe i qëndrueshëm në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, në bazë të modelit të zhvillimit poli-centrik,

- ulja e dallimeve mes dhe në kuadër të rajoneve planore dhe ngritja e cilësisë së jetës për gjithë qytetarët,
- rritja e konkurrencës së rajoneve planore me anë të përforcimit të kapacitetit të tyre inovativ, përdorimit optimal dhe vlerësim të pasurive natyrore, kapitalin njerëzor dhe aftësitë ekonomike të rajoneve të ndryshme,
- rritje dhe zhvillim të identitetit të veçantë të rajoneve planore, si dhe afirmimi i tyre dhe zhvillimi,
- ringjallja e fshatrave dhe zhvillimi i rajoneve me nevoja të posaçme zhvillimore, dhe
- mbështetja e bashkëpunimit mes komunave dhe ndërkufitar të njësisë të vetëqeverisjes lokale në funksion të nxitjes së zhvillimit të barabartë rajonal.

KORNIZA 1: POLITIKAT PARAPRAKE PËR ZHVILLIM RAJONAL

Politika për Zhvillim të Barabartë Rajonal, sipas disa prej dokumenteve të saja është rezultat i “mungesës së politikës rajonale zhvillimore deri në vitin 2007”, ndonëse në fakt edhe më herët ka ekzistuar politika e “zhvillimit më të shpejtë ekonomik të rajoneve më pak të zhvilluara”, dhe për atë qëllim ka ekzistuar kritere për pa zhvillim, ka pasur Fond për kreditim të zhvillimit më të shpejtë të rajoneve dobët të zhvilluara ekonomike, ndërsa në vitin 1994 Kuvendi ka miratuar Ligjin për nxitjen e Zhvillimit të Rajoneve më Pak të Zhvilluara⁹, që ka parashikuar transferim të mjeteve financiare në shumë prej 1% të PBB për rajonet më pak të zhvilluar ekonomike (rreth 6 milion dollarë mjete në vitin në 1994 ishin planifikuar për këtë qëllim¹⁰).

Gjatë viteve të para pas pavarësimit të RM ka pasur edhe Ministri të Zhvillimit, që ka pasur kompetenca edhe për ndihmën e rajoneve të pazhvilluara, ndërsa Ministrja e atëhershme për Zhvillim, Sofija Todorova, në debat kuvendor gjatë miratimit të këtij ligji ka pohuar që dispozitat ligjore kanë parashikuar intervenim shtetërorë për të nxitur zhvillimi i rajoneve më pak të zhvilluara.¹¹

Ashtu, sipas të dhënave nga Byrja për Rajone Ekonomike më pak të Zhvilluara, në vitin 2000 janë transferuar mjete në shumë prej 0.30% të PBB për këto rajone, në vitin 2001 – 0.2%, në vitin 2002 - 0.4%, në vitin 2003 0.1%, në vitin 2004 – 0.08, ndërsa në vitin 2005 – 0.06%.¹²

9 Rajonet më pak të zhvilluara ekonomike ishin 64% të territorit të plotë të RM, në të cilat ka jetuar 22% e popullatës në momentin që ishte miratuar ky ligj (1994)

10 Stenogram i debatit në Kuvend: <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/71sednica7prod12jan94god.pdf>

11 Stenogram i debatit në Kuvend: <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/71sednica7prod12jan94god.pdf>, fq. 51

12 Plani Kombëtar Zhvillimor 2007-2009, Qeveria e RM, Shkup, shkurt 2007, fq. 57

Si burime të financimit të zhvillimit rajonal janë theksuar: Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, fondet e Bashkimit Evropian, burime tjera ndërkombëtare, donacione dhe sponsore nga persona fizik dhe juridik dhe mjete tjera të përcaktuar me ligj. Për nxitje të ZHBR nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vit duhet të ndahen mjete në shumë prej së paku 1% të produktit të brendshëm bruto.

Mjetet për nxitjen e ZHBR i shpërndan Qeveria e Republikës së Maqedonisë, edhe atë:

- 70% për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore,
- 20% për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, dhe
- 10% për financim të projekteve për zhvillim të fshatrave.

Mjetet për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore shpërndahen nëpër rajonet planore në përputhje me klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit. Bazë për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore paraqesin indeksi i zhvillimit ekonomik dhe indeksi demografik. Kriteria më të afërt dhe indikatorë për caktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore përcaktohen me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Klasifikimi i rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit përcaktohet me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhë prej pesë viteve.¹³ Mjetet transferohen në llogari të Byrosë për Zhvillim Rural (në tekstin e mëtuajtshëm: Byroja) që zbaton vendimin për shpërndarjen e tyre.¹⁴

Në periudhën kur miratohej Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal, Republika e Maqedonisë kishte PBB mesatar për banor prej 30% nga mesatarja e BE 27 në vitin 2007, dhe me atë veçohej me shkallë të ultë të zhvillimit ekonomik. PBB-ja në rajonin më të zhvilluar planor (i Shkupit) ishte 44.5% nga mesatarja e BE27, ndërsa për më pak të zhvilluar (Verilindor) vetëm 13.1%. Në atë periudhë Rajoni i Shkupit ka pasur 3.4 herë PBB më të lartë për banor në Rajonin Verilindor që ka paraqitur një mospërputhje e rëndësishme dhe sfidë për efikasitetin e masave, qëllimeve dhe aktiviteteve për zhvillim të barabartë rajonal që për kornizë kanë pasur ligjin e miratuar. Mospërputhja e lartë në zhvillim të rajoneve planore në Maqedoni vërehet edhe nga krahasimi i indeksit zhvillimor, ekonomik-social dhe demografik (shikoni Figurën 1 dhe Tabelën 10 më poshtë), ku dukshëm vërehet

¹³ Klasifikimi i parë për nivelin e zhvillimit të rajoneve planore është bërë në bazë të Vendimit për kritere dhe indikatorë të afërt për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore (Gazeta Zyrtare nr. 162/08). Sipas këtij vendimi, indeksi zhvillimor përcaktohet si një mesatare e caktuar nga indeksi ekonomik-social dhe demografik, gjatë së cilës dy indekset kanë pjesëmarrje të njëjtë në krijimin e indeksit zhvillimor. Gjatë përcaktimit të indeksit ekonomik-social si indikatorë përdoren: produkti i brendshëm bruto për banorë, të ardhurat buxhetore për banorë, rritja e vlerës së shtuar të sektorit jo-financiar dhe shkalla e papunësisë, ndërsa indeksi demografik përcaktohet në bazë të rritjes natyrore të popullsisë, koeficientit të plakjes, saldoja e migracionit të 1000 banorëve dhe studentë të diplomuar në 1000 banorë.

¹⁴ Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal, teksti i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë" nr. 63/2007, 187/2013, 43/2014 и 215/2015), Neni 33

dallimi mes Rajonit të Shkupit nga njëra anë dhe rajonet tjera nga ana tjetër, veçanërisht në fushën ekonomike-sociale.

Figura 1 – Krahasim i shkallës së zhvillimit të rajoneve planore për periudhën 2008-2012




Tabela 10: Klasifikimi i rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve planore për periudhën 2008-2012

Rajoni planor	Sipas indeksit zhvillimor	Sipas indeksit ekonomik-social	Sipas indeksit demografik
Shkupit	1,48	1,86	1,25
Juglindor	0,89	1,38	0,58
Pellagonisë	0,73	0,79	0,69
Jugperëndimor	0,72	0,50	0,86
Pollogu	0,72	0,18	1,05
Vardari	0,69	0,63	0,73
Lindor	0,67	0,95	0,50
Verilindor	0,56	0,33	0,70


Burimi: Vendim për klasifikim të rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit për periudhën 2008-2012, Gazeta Zyrtare Nr. 162/2008

Indekset (zhvillimor, ekonomik-social dhe demografik) të rajoneve planore tregojnë sa rajonet dallohen në zhvillim në krahasim me mesataren e vendit, gjatë së cilës:

- Indeksi 1 shënon që niveli i zhvillimit të rajonit planor është e barabartë me zhvillimin mesatar në nivel të Republikës së Maqedonisë;
- Indeksi më i lartë se 1 shënon që niveli i zhvillimit të rajonit planor është më i lartë nga zhvillimi mesatar në nivel të Republikës së Maqedonisë dhe
- Indeksi më i vogël se 1 shënon që niveli i zhvillimit të rajonit planor është më i ultë nga zhvillimi mesatar në nivel të Republikës së Maqedonisë.

Në bazë të klasifikimit të shkallës së zhvillimit të rajoneve planore është bërë një kalkulim i pjesëmarrjes së rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për financim të projekteve për zhvillimin e rajoneve planore në periudhën 2008-2012. Në krahasim me atë, pothuaj se gjitha rajonet është parashikuar të fitojnë së paku dy herë më shumë mjete në krahasim me Rajonin Planor të Shkupit, për të cilin do të ndahen 6.4% të mjeteve të plota në dispozicion, që në nivelin vjetor, do të ndahen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Figura 2 - Pjesëmarrje e rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për zhvillimin rajonal për periudhën 2008-2012 (në %)



Burimi: Vendimi për klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve planore për periudhën 2008-2012, Gazeta Zyrtare Nr. 162/2008

Mjetet për nxitjen e zhvillimit rajonal janë synuar për zvogëlimin e mospërputhjeve mes dhe brenda rajoneve. Në përputhje me rregulloren ligjore dhe nënligjore, shfrytëzimi i mjeteve është drejtpërdrejtë kushtëzuar nga parashtrimi dhe realizimi i projekteve cilësore për nxitjen e zhvillimit të rajoneve, që nga ana tjetër, varet nga kapacitetet e planifikimit dhe zbatimit të projekteve zhvillimore në rajonet. Nga kjo, gjatë vendosjes së sistemit për zhvillim rajonal vëmendje të posaçme duhet të dedikohet edhe atij komponenti – zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve relevante që është një përcaktues i rëndësishëm për fitimin/shfrytëzimin e mjeteve nga rajonet planore.¹⁵

Në vitin 2013 Qeveria miratoi klasifikim të ri të rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve planore për periudhën 2013-2017:¹⁶

¹⁵ Strategjia për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019, "Gazeta Zyrtare e RM, nr. 119 të 30.09.2009 (Fq. 13,14)

¹⁶ Vendimi për klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve të planifikimit për periudhën 2013-2017, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr.88/2013

Tabela 11: Klasifikimi i rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve planore për periudhën 2013-2017

Rajoni planor	Sipas indeksit zhvillimor	Sipas indeksit ekonomik-social	Sipas indeksit demografik
Shkupit	1,51	1,48	1,53
Juglindor	0,97	1,29	0,72
Lindor	0,96	1,36	0,65
Pellagonisë	0,91	1,09	0,80
Pollogu	0,82	0,50	1,07
Jugperëndimor	0,81	0,98	0,69
Vardari	0,73	0,70	0,76
Verilindor	0,63	0,27	0,90

Në bazë të kësaj, pjesëmarrja e rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për zhvillim rajonal gjatë këtyre 4 viteve është ndryshuar për një fraksion dhe duhet të jetë në përpjesëtimin vijues:

Figura 3 - Pjesëmarrje e rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për zhvillimin rajonal (në %) për periudhën 2013-2017




Tabela 12 - Pjesëmarrje e rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për zhvillimin rajonal


Rajoni (pjesëmarrje në shpërndarjen e mjeteve)	2008-2012 (në %)	2013-2017 (në %)	Ndryshimi
Verilindor	16,7	17,3	+ 0,6
Lindor	14	11,3	-2,7
Vardari	13,5	14,7	+1,2
Pollogu	13	13,2	+0,2
Jugperëndimor	13	13,3	+0,3
Pellagonisë	12,9	11,9	- 1
Juglindor	10,6	11,1	+0,5
Shkupit	6,4	7,2	+0,8


Indekset zhvillimore të rajoneve planore në Republikën e Maqedonisë tregojnë që vetëm Rajoni Planor i Shkupit veçohet me shkallë mbi mesatare të zhvillimit, ndërsa gjitha rajonet tjera janë nën mesataren kombëtare. Gjatë kësaj, dallimi mes rajonit të Shkupit, dhe të dytit me rend sipas zhvillimit – Juglindor, është e rëndësishme (indeksi 1.48 dhe 0.89) megjithatë dallimi mes rajonit të Shkupit dhe të fundit me rend sipas zhvillimit – Verilindor është mjaft i madh (indeks 1.48 dhe indeks 0.56).

KORNIZA 2: DATA TË RËNDËSISHME PËR POLITIKËN E ZHBR

- **1994** – Miratohet Ligji për Nxitjen e Zhvillimit të Rajoneve Ekonomike më pak të Zhvilluara, që ka parashikuar gjenerimin e mjeteve për zhvillim të rajoneve ekonomike më pak të zhvilluara nga Buxheti Qendror, në shumë prej 1% të PBB në vit
- **2001** – Miratohet nomenklatura e njësisve statistikore territoriale (NNJST) në Maqedoni sipas të cilës gjithë territori i Maqedonisë është një njësi NJST nivelet 1 dhe 2, ndërsa NNJST niveli 3 ka tetë rajone statistikore.
- **15 maj 2007** - Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miraton Ligjin për Zhvillim të Barabartë Rajonal
- **2007-2009** – Themelohen tetë Qendrat për Zhvillim të Rajoneve Planore I pari ishte themeluar ai i Pollogut, në afatin e parashikuar ligjor prej 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit për ZHBR, ndërsa i fundit ishte themeluar i Shkupit në maj 2009.
- **Gusht 2008** – Këshilli për Zhvillim të Barabartë Rajonal ka miratuar vendim për klasifikim të rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit për periudhën 2008-2012 dhe vendim për kriteret më të afërt dhe tregues për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore
- **Dhjetor 2008** – Ishte bërë klasifikim i rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit.
- **Janar 2009** – Qeveria ka miratuar Programet për mbështetje financiare të zhvillimit rajonal në vitin 2009 (programi “Plane Tërheqëse Planore për vitin 2009” që zbatohet me anë të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale me buxhet të plotë prej 150.000.000 denarë dhe Programi për zhvillim rajonal i barabartë dhe i qëndrueshëm, që zbatohet nëpërmjet Byrosë për Zhvillim Rajonal në shumë prej 166.500.000 denarë).
- **Maj 2009** – Këshilli për Zhvillim të Barabartë Rajonal ka miratuar vendim për kriteret dhe tregues më të afërt për caktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe vendim për përcaktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2009 deri 2013. Sipas tyre
- **Gusht 2009** – Byroja për Zhvillim Rajonal për herë të parë ka publikuar Thirrje Publike për mbledhjen e projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe zhvillim të fshatrave që do të financohen nga programet e MVL, ndërsa në kohën e njëjtë ka dërguar letër qarkullimi tek kryetarët e rajoneve planore për gatishmërinë të mbledhin propozim projekte për zhvillim të rajoneve planore. Ndonëse Qeveria ka miratuar vendime për financim të projekteve, për ata nuk ishin paguar mjete të mjaftueshme nga buxhetet në qendrat për zhvillim të rajoneve planore, andaj mjetet e parashikuara për vitin 2010 u drejtuan për financim të projekteve të aprovuar në vitin 2009. Projektet e arritura për vitin 2010 u transferuan në vitin 2011 dhe prandaj në vitin 2011 nuk u shpall thirrje publike për aplikim të projekteve.

- **29 shtator 2009** – Kuvendi i RM ka miratuar Strategjinë për ZHR në RM
- **Nëntor-dhjetor 2009** – Qendrat për zhvillim të rajoneve planore i miratojnë programet për zhvillim të rajoneve planore. Rajoni i Shkupit dhe Verilindore kanë të bëjnë me periudhën 2009-2014, lindor dhe Juglindore për 2009-2013, Vardarit për 2008-2013, Pellagonisë dhe Jugperëndimore për 2010-2015.
- **Dhjetor 2009** – Qeveria e RM miraton vendim për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore, duke ndarë 131.810.000 milion denarë nga Buxheti i RM-së.
- **Mars 2010** – Qeveria e RM miraton Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2010-2012.
- **2012** – Qeveria e RM ka kyçur ZHBR në përbërje të prioriteteve
- **Prill 2013** – Qeveria e RM miraton Vendim për klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit për periudhën 2013-2017, sipas të cilës Rajoni i Shkupit ka indeks zhvillimi 1051 në krahasim me mesataren e RM, Juglindor 0.97, Lindor 0.96, Pellagonisë 0.91, Pollogut 0.82, Jugperëndimor 0.81, Vardarit 0.74 dhe Verilindor 0.63. Në bazë të këtij klasifikimi, është bërë kalkulimi për pjesëmarrje të rajoneve planore në shpërndarjen e mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore në periudhën 2013-2017
- **Qershor 2013** – Qeveria e RM miraton Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2013-2015.
- **Shkurt 2014** – Qeveria e RM miraton Vendim për përcaktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore 2014-2018
- **2014** – Miratohet Strategjia për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal, me të cilën janë zvogëluar parametrat për rezultatet e pritura në 2019 (fillimisht ishte planifikuar: PBB mesatar për banorë të arrijë 50% nga mesatarja e BE – e zvogëluar në 42%; rajoni më pak i zhvilluar planor të ketë PBB për banor jo më të ultë se 35% nga mesatarja e BE – e zvogëluar për 26%; e planifikuar: dallimi në PBB për banor nga rajoni më i zhvilluar dhe më pak i zhvilluar të mos tejkalojë 2.5 herë – e zvogëluar në 2.2 herë)
- **Nëntor-dhjetor 2014** – Qendrat për zhvillim të rajoneve planore i miratojnë programet për zhvillim të rajoneve planore me kohëzgjatje prej 2014 deri 2019.
- **Qershor 2016** – Qeveria e RM miraton Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2016-2018.





STRATEGJIA DHE PLANE TË VEPRIMIT PËR ZHVILLIMIN E BARABARTË RAJONAL

Strategjia për ZHBR, që në shumë aspekte bazohej në projektimet e Planit Kombëtar Zhvillimor 2007-2009, planifikohej sipas politikave makro-ekonomike të shtetit që janë drejtuar për sigurimin e nivelit vjetor të rritjes prej rreth 6.5% në periudhën e përmendur, dhe nëse rritja ende do të zhvillohet më tutje me shpejtësi të njëjtë, do të arrihen rezultatet vijuese:

- PBB mesatar për banor (sipas PKM) në Republikën e Maqedonisë të arrijë 50% nga mesatarja e BE në vitin 2019;
- rajoni më pak i zhvilluar planor në Republikën e Maqedonisë të ketë PBB për banorë (sipas PKM) jo më të ultë se 35% nga mesatarja e BE në vitin 2019, dhe
- dallimi në PBB për banorë në rajonin më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar planor mos të tejkalojë 2.5 herë në vitin 2019.

Për fat të keq, këto projekte tepër ambicioze nuk u realizuan, ndonëse pjesa më e madhe prej tyre ishin bërë në periudhën kur botën e kaploi kriza e madhe financiare që pa dyshim do të kishte efekte edhe mbi ekonominë maqedonase dhe për këtë duhej të jenë më të vërteta. Gjatë viteve të fundit

rritja e PBB në shtet asnjëherë nuk ka arritur 6.5% të projektuar (sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, niveli më i lartë u arrit në vitin 2008 me 5.5% rritje të PBB dhe në vitin 2015 me 3.8% rritje të PBB)¹⁷, ndërsa sipas raportit të fundit të BE për përparimin e Maqedonisë, PBB për kokë në vitin 2014 ka arritur 37% nga mesatarja e 28 shteteve anëtare të BE.¹⁸

Në vitin 2014, Qeveria, gjegjësisht Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, ka bërë revizion të Strategjisë për Zhvillim Rajonal dhe Kuvendi i RM ka miratuar Strategji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të vitit 2014. Disa prej ndryshimeve më të rëndësishme kanë të bëjnë me qëllimet strategjike, gjatë së cilës në vend të PBB mesatare për banor të arrihet 50% nga mesatarja e BE, siç ishte planifikuar në vitin 2009, në dokumentin e ri ky projektim është zvogëluar në 42% nga mesatarja e BE. Në vend që rajoni më pak i zhvilluar planor të ketë PBB për banor jo më të ultë se 35% nga mesatarja e Be, me dokumentin e ri projektohet ky parametër të zvogëlohet në 26%. Gjithashtu, në vend që dallimi në PBB për banorë mes rajonit më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar të mos kalojë 2.5 herë (siç parashikohen me strategjinë e vitit 2009), në vitin 2014 ky dallim është zvogëluar në 2.2 herë.¹⁹

Përveç projekteve të gabuara, politika u përballua edhe me shumë vonesa të zbatimit të komponentëve kryesore. Një prej segmenteve më kryesore të zbatimit të kësaj politike janë Qendrat për Zhvillim të Rajoneve Planore që duhet të formohen më të voni 9 muaj nga miratimi i Ligjit, megjithatë përveç qendra e Pollogut, gjitha tjerët e kanë tejkaluar këtë afat. I fundit ishte formuar qendrat e Shkupit, në maj 2009, me vonesë prej 14 muajve, pas skadimit të afatit ligjor. Funkzioni i tyre, mes tjerash, është koordinim i ndihmës nga Qeveria dhe donatorët për zhvillim rajonal, si dhe miratimi i Programeve pesëvjeçare për zhvillim të rajoneve planore. Madje edhe në lidhje me programet ishte tejkaluar afati për miratimin e tyre (duhet të përfundohet në afat prej 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, gjegjësisht mars 2008 dhe të gjithë janë miratuar në fund të vitit 2009).

Nga fillimi i funksionimit të Qendrave të Rajoneve Planore, ata kanë pasur probleme rreth financimit të tyre. Sipas ligjit, 50% të të ardhurave të tyre duhet të vijnë nga Buxheti i RM, ndërsa 50% tjerat duhet të transferohen nga buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale (në tekstin e më tutjeshëm: NJVL) të cilat janë përfshirë në rajonin që mbulon secila prej tetë qendrave për zhvillim të RP. Një pjesë e madhe e NJVL nuk kanë përfunduar me kohë këtë obligim (ndërsa disa nuk kanë paguar dhe disa vite më tutje) dhe ajo e përfundon punën e qendrave. Ky problem tek disa prej qendrave ende e ngadalëson punën e tyre, dhe ajo, mes tjerave, ka për pësojë efikasitet të vogël në mbledhjen e mjeteve nga donatorëve të huaj për zhvillimin e disa rajoneve.

17 Të dhënat janë marrë nga ueb faqja e Ministrisë së Financave, Kategoria: Makro-ekonomi, nën-kategoria: indikatorë dhe projekte, <http://finance.gov.mk/mk/node/401>, qasur më 5 nëntor 2016.

18 The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report, Brussels, 9.11.2016, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

19 Strategjia për Ndryshimin dhe Plotësimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, shtator 2014

Nga ana tjetër, sërish, edhe përse gjatë gushtit 2009 Byroja shpalli Thirrje Publike për mbledhjen e projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe zhvillim të fshatrave që duhet të financohen nga Buxheti i RM (dhe në kohën e njëjtë të dërgojë edhe letër qarkulluese tek kryetarët e rajoneve planore për gatishmërinë e mbledhjes së propozim projekteve për zhvillim të rajoneve planore) dhe ndonëse Qeveria ka marrë vendime për financim të projekteve, për ata nuk u paguan mjaft mjete të buxhetit ndaj qendrat për zhvillim të rajoneve planore, dhe prandaj mjetet e parashikuar për vitin 2010 u orientuan për financim të projekteve të aprovuar në vitin 2009. Projektet e arritura për vitin 2010 u transferuan në vitin 2011 dhe prandaj në vitin 2011 nuk u shpall thirrje publike për aplikim të projekteve.²⁰ Pastaj thirrjet për aplikim për projekte shpallëshin me dinamikë relative të rregullt.

Me anë të ueb faqes së Byrosë për Zhvillim Rajonal, mund të arrihet në të dhëna për atë sa mjete ka shpërndarë Qeveria me anë të Byrosë gjatë viteve të fundit (shiko tabelën më poshtë)²¹:

Tabela 13: Mjete të ndara nga Buxheti i RM për ZHBR nëpërmjet Byrosë për Zhvillim Rajonal

Viti	Për projekte për zhvillim të rajoneve planore,	Për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore	Për projekte për zhvillim të fshatrave
2016	179.315.540	51.233.010	25.118.635
2015	91.276.253	26.385.800	13.192.900
2014	42.095.533	12.027.295	6.013.648
2013**		14.845.732	7.422.866
2012	13.322.925	3.806.550	1.903.000
2011	92.065.766	26.304.505	13.152.252
2010*			
2009	131.810.000	37.660.000	18.481.250

Burimi: Byroja për Zhvillim Rajonal

* në vitin 2010 nuk janë paraparë mjete për projekte për zhvillim të rajoneve planore

**për vitin 2013 në internet faqen e Byrosë për zhvillim rajonal nuk është në dispozicion e dhëna për mjetet e parapara për projekte për zhvillim të rajoneve planore

20 Shkalla e Zhvillimit dhe Klasifikimi i Rajoneve Planore (elaborat i ekspertëve), Vlabor, Shkup, maj 2013, fq.17

21 www.brr.gov.mk (qasur më 24.10.16)

Një prej komponentëve më kryesore në kornizën ligjore për financim të kësaj politike është transferimi i 1% të PBB deri në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë, që pastaj në bazë të klasifikimit të zhvillimit të rajoneve, do të transferojnë përqindje përkatëse të këtyre mjeteve në secilin prej rajoneve (për më pak të zhvilluarit, më shumë mjete, për më të zhvilluarit, më pak mjete). Me çdo buxhet të ri, rebalanc të buxhetit dhe llogari përfundimtare të buxhetit të RM, si dhe çdo plan i ri i aksionit për zbatimin e strategjisë për ZHBR del që përkundër kësaj kornize ligjore, Qeveria ka metodologji tjetër në bazë të cilës i kalkulon përqindjes nga PBB që investohen në ZHBR.

Plane Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Republikën e Maqedonisë

Deri më tani, janë miratuar tre Plane Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni. - të gjitha tre planet e veprimit me vonesë në lidhje me afatin e caktuar ligjor deri më vonë gjashtë muaj nga skadimi i periudhës aktuale planore.²²

Plani i Veprimit i parë për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë 2010-2012 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar në seancën e zhvilluar më 20 prill 2010.

Me këtë dokument u konfirmua ajo që dy vitet më para vërehej me shtyrjen e procedurave për zbatimin e obligimeve ligjore për ZHBR dhe ndarjen e mjeteve për ZHBR nëpërmjet buxheteve shtetërore dhe rebalancët e buxheteve për vitet 2008 dhe 2009. Në vend që të respektohet obligimi ligjor për shpërndarjen e 1% të PBB për zhvillimin rajonal nëpërmjet NJVL (ose Byrosë për Zhvillim Rural), me këtë dokument bëhet zyrtare qëndrimi i Qeverisë që këto mjete të alokojë në buxhetet e më tepër ministrive dhe agjencive që kanë si kompetencë komponentët rajonale pa obligim të ndajë sipas metodologjisë për pjesëmarrje në rajonet planore në shpërndarjen e mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore. Me këtë qasje në fakt krijuesit e kësaj politike në një segment e kanë kthyer procesin e zhvillimit të rajoneve më pak të zhvilluar në nivel që ka ekzistuar edhe para miratimit të ligjit dhe strategjisë për ZHBR. Pikërisht metodologjia për nxitjen e zhvillimit të rajoneve në përpjesëtim me shkallën e mungesës së zhvillimit të tyre ishte dallimi i ri specifik në lidhje me politikën paraprake, për të cilën bartësit e politikës së re kanë pohuar që ka qenë “monocentrik”. Në pjesën më të madhe të raporteve të pavarura për politikën e ZHBR shfaqen të dhëna sipas të cilave mjetet financiare të Qeverisë për këtë politikë në asnjë vit nuk ka arritur nivelin e preferuar prej 1% të PBB, ndërsa raportet e Qeverisë disponojnë me të dhëna që lëvizin diku rreth 1% deri më 3.25% të PBB, ndonëse me rëndësi është që këto përqindje kanë të bëjnë vetëm me atë që është planifikuar, dhe jo atë që është realizuar, gjegjësisht konfirmuar me të dhëna konkrete nga llogaritë përfundimtare të buxheteve.

²² Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal, teksti i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë” nr. 63/2007, 187/2013, 43/2014 и 215/2015), Neni 10

Duke pasur parasysh këto të dhëna imponohet konkluzion asnjë prej planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal nuk prezantohen përqindjes sipas metodologjisë që e parashikon Ligji dhe Strategjia për ZHBR dhe të cilët në periudhën prej 2008 deri 2015 kanë qenë mes 0.002 dhe 03% nga PBB.

Megjithatë, duhet të theksojmë që në Planin e Veprimit për 2010-2012 mund të lexohet kjo: “në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2009 ishin planifikuar 4.568 milion denarë për mbështetje të zhvillimit rajonal, që ka paraqitur 1.15% të prodhimit të brendshëm bruto. Ndonëse këto mjete ishin alokuar (me parashenjën “rajonale) dhe nuk kanë qenë të menaxhuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, ajo sërish paraqet një lloj përmirësimi – praktikë e ndryshme dhe përpjekje serioze e vendit për mbështetje të zhvillimit rajonal. Do të duhet një kohë që të zhvillohen mekanizma dhe të përforcohet politika e përforcuar rajonale e vendit dhe në këtë mënyrë do të mundësohet shpërndarje e mjeteve drejtpërdrejtë për mbështetje të zhvillimit të barabartë rajonal”.²³ Nga ky dokument mund të veçojmë edhe pjesët vijuese që konfirmojnë pozitën e Qeverisë për metodologji të ndryshme për kalkulimin e investimit në ZHBR në krahasim me përcaktimin ligjor:

“Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2010 janë siguruar mjete me shumë të plotë prej 6.307.85 milion denarë, që paraqesin 1.53% të prodhimit të brendshëm buro të vlerësuar për vitin 2010 prej 413.066 milion denarë. Ato janë mjetet e plota që janë planifikuar për mbështetje të projekteve me komponentë zhvillimore rajonale dhe janë planifikuar në programe të ndara dhe nën-programe në ministri të ndryshme, që do të thotë se zbatohen sipas politikave të tyre të mbështetjes së zhvillimit.”²⁴

23 Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2010-2012, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, mars 2010 (fq. 1,2)

24 Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2010-2012, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, mars 2010 (fq. 42)

Tabela 14: Mjete të planifikuara nga Buxheti i RM për zhvillim rajonal, 2009-2012, në milion denarë

Burimi i financimit	2009	2009 (rebalanc)	2010	2011	2012	Gjithsej 2010- 2012
IPA*						
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	425,23	372,13	333,52	442,24	464,35	1.240,11
Ministri tjera lineare	4.143,34	3.397,51	5.974,33	6.213,30	6.523,97	18.711,60
Gjithsej	4.568,57	3.769,64	6.307,85	6.655,54	6.988,32	19.951,71

Burimi: Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2010-2012

** Në Planin e Aksionit nuk ka të dhëna për financim nga IPA fondet

Tabela 15: Mjete të planifikuara nga buxhetet e ministrive që në vete kanë komponentë rajonale zhvillimore dhe janë të synuar për mbështetje të zhvillimit rajonal, në milion denarë

Institution	2009	2009 (budget adjustment)	2010	2011	2012	Total 2010 - 2012
Ministria e Financave	26,74	19,99	442,29	459,98	482,98	1.385,25
Ministria e Ekonomisë	233,13	199,83	590,00	613,60	644,28	1.847,88
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	248,40	243,35	215,50	224,12	235,33	674,95
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	823,78	607,70	1.616,60	1.681,26	1.765,33	5.063,19

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit	654,47	276,43	770,62	801,44	841,52	2.413,58
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit	500,00	500,00	632,00	657,28	690,14	1.979,42
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	74,00	66,29	75,48	78,50	82,42	236,40
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	642,90	804,00	628,89	654,05	686,75	1969,68
Agjencia për të Rinj dhe Sport	390,00	300,00	471,00	489,84	514,33	1475,17
Ministria e Shëndetësisë	49,92	49,92	201,95	210,03	220,53	632,51
Agjencia për Rrugë Shtetërore	500,00	330,00	330,00	343,20	360,36	1033,56
Gjithsej:	4.143,34	3.397,51	5.974,33	6.213,30	6.523,97	18.711,60

Burimi: Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2010-2012

Arsyetimi në këtë plan veprimi përse këto mjete janë shfaqur në këtë tabelë është se me ata do të financohen projekte që kanë fokus zhvillimin rajonal, gjegjësisht kontribuojnë për nxitjen e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht ato janë projekte që kanë karakter zhvillimor dhe mund të japin kontribut për rritjen e produktit të brendshëm bruto dhe punësinë në rajone të caktuara.²⁵

²⁵ Këtu mungon edhe arsyetimi nëse mjetet e buxheteve tjera të “ministrive tjera lineare” shpërndahen në përputhje me vendimin për klasifikim të rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit. Nëse ndodh ajo, do të mund të pranohen argumentet e përgatitësve të Planeve të Veprimit që këto mjete kontribuojnë për zhvillim të barabartë rajonal në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Në gusht të vitit 2013, Qeveria e RM ka miratuar Planin e Veprimit të dytë për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim në Maqedoni 2013-2015. Gjithashtu, në këtë dokument vazhdohet me metodologjinë e njëjtë të kalkulimit të 1% PBB të parashikuar me ligj për ZHBR. “Me buxhetin e vitit 2012 (pas rebalancit) janë siguruar 4.259.98 milion denarë, që janë 0.88% e PBB të vlerësuar për vitin 2012 (481.808 milion denarë). Ndonëse këto mjete ishin alokuar në buxhetet e më tepër ministrive dhe agjencive (me parashenjën “rajonale) dhe nuk kanë qenë të menaxhuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, ajo sërish paraqet një lloj përpjekje serioze e vendit për mbështetje të zhvillimit rajonal.”²⁶

Tabela 16: Mjete financiare për mbështetje të zhvillimit rajonal 2012-2015 (në mijëra denarë)

Burimi i financimit	2012	2012 (rebalanc)	2013	2014	2015	Gjithsej (2013-15)
MVL dhe BZHR	175.600	77.360	99.035	103.780	118.880	321.695
Ministri tjera lineare	4.774.500	4.181.520	4.492.836	4.331.619	4.835.600	13.661.055
Gjithsej	4.950.100	4.258.880	4.591.871	4.430.654	4.954.480	13.982.750

Burimi: Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015

Tabela 17: Mjete financiare për mbështetje të zhvillimit rajonal 2012-2015 për MVL dhe Byronë (në mijëra denarë)

Ndarja	Institucioni	Synimi	2012	2012 (rebalanc)	2013	2014	2015	Gjithsej
19101	MVL	ZHBR	109.000	27.860	49.992	53.780	63.880	167.652
28001	BZHR	ZH dhe ZHR i qëndrueshëm	65.500	49.500	49.043	50.000	55.000	154.043
	Gjithsej		174.500	77.360	99.035	103.780	118.880	321.695

²⁶ Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013, fq. 2

Përveç mjeteve të theksuara për ZHR, Buxheti i RM për vitin 2013, në buxhetet e ministrive tjera lineare përmban mjete që në vete kanë komponentë rajonale zhvillimore dhe janë të synuar për mbështete të ZHR.²⁷

Plani i fundit i veprimit, i publikuar në qershor 2016 vlerëson që me Buxhetin e RM për vitin 2016 janë parashikuar mjete në shumë prej 19.000.512.000 denarë (ose rreth 3.25% prej PBB të vlerësuar për vitin 2016).²⁸ Duhet të theksohet që në këto mjete autorët i kalkulojnë edhe mjetet nga projekte të ministrive që nuk janë anëtare të Këshillit për Zhvillim të Barabartë të RM (si Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Shëndetit), ashtu që nuk duhet të habit fakti që në dokumentet vijuese Qeveria pohon që pjesa më e madhe e Buxhetit të RM është në funksion të zbatimit të politikës së ZHBR.


Në këtë plan të veprimit theksohet se në periudhën pas miratimit të politikave rajonale zhvillimore janë realizuar masa dhe aktivitete për nxitjen e ZHBR, në bazë të cilës është arritur zvogëlim i dallimeve në zhvillim në qytetin e Shkupit dhe rajonet tjera planore. Janë prezantuar të dhëna që për nxitjen e ZHBR janë aprovuar 230 projekte në vlerë prej 264.820.014 dhe janë financuar 390 projekte zhvillimore me vlerë të plotë prej 602 milion denarë (pothuaj se 10 milion euro) nga ana e MVL, në bazë të prioriteteve të identifikuara zhvillimore të rajoneve planore dhe strategjive zhvillimore.²⁹

Pas këtyre të dhënave imponohet konkluzioni që në asnjë prej planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal nuk prezantohen përqindjes sipas metodologjisë që e parashikon Ligji dhe Strategjia për ZHBR dhe të cilët në periudhën prej 2008 deri 2015 kanë qenë mes 0.002 dhe 03% nga PBB.

27 Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013, fq. 45,46 Në dokumentin janë dhënë projektet që planifikohen të financohen me mjetet e Buxhetit të RM dhe që kanë fokus zhvillimin rajonal, gjegjësisht kontribuojnë për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal në gjithë territorin e RM-së. Arsyetimi për kyçjen e tyre është se bëhet fjalë për projekte që kanë karakter zhvillimor dhe mund të japin kontribut për rritjen e PBB dhe punësisë në rajone të caktuara. Mes tyre, edhe paragrafë buxhetore, që sipas ndarjes, programit, nën-programit, kategorisë dhe paragrafit kanë karakter rajonal sipas përshkrimit në dispozicion, por shpesh pa arsyetim të qartë për efektin rajonal dhe ndikim të aktiviteteve. Për shembull, në mesin e tyre janë përfshirë edhe mjetet e planifikuar për zona zhvillimore industriale teknologjike që janë kompetencë e Ministrisë së Ekonomisë, për investime në mjedisin jetësor që janë në kompetencë të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, investimet në infrastrukturën e hekurudhave në kompetencë të Ministrisë për Transport dhe Lidhje, mjetet për nxitje të punësimit, në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, mjetet për zhvillim të resurseve njerëzore nga programi MG i Ministrisë së Financave, etj.

28 Kjo rritje e buxhetit është theksuar edhe në raportin e fundit të përparimit të Maqedonisë i përgatitur nga Be-ja për vitin 2016, ku theksohet që zhvillimi i barabartë rajonal është një pjesë e rëndësishme e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, që Plani i Veprimit 2016-2019 parashikon shpërndarje më transparente dhe të barabartë të mjeteve shtetërore, që buxheti për zhvillim rajonal është dyfishuar në vitin 2016 dhe që buxheti për vitin 2017 parashikon një rritje tjetër, por ajo sërish nuk do të mjaftojë.

29 Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2016-2018, Gazeta Zyrtare e RM 123/2016, fq 2



EFIKASITETI I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË BARABARTË RAJONAL

Duke marrë parasysh që të dhënat për efikasitetin e politikës për ZHBR janë relativisht të kufizuar, në vazhdimësi do të mundohemi do të prezantojmë dhe analizojmë të dhënat e gatshme që kanë të bëjnë me tregues të vlerësimit të efekteve (ndikimeve) nga zbatimi i Strategjisë për ZHBR 200-2019 që janë prezantuar në tre planet e veprimit.

Në planin e parë të veprimit është prezantuar tabela më poshtë:³⁰

30 Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2012-2015, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, mars 2010 (fq. 20)

Tabela 18: Tregues të vlerësimit të efekteve (ndikimeve) nga zbatimi i Strategjisë 2009 - 2019

	Индикатор	2009 Vlerë	2019 Vlerë
1	PBB mesatar rajonal për banorë në Republikën e Maqedonisë (sipas PKM)		së pakur 50% të mesatares së BE
2	PBB për banorë (sipas PKM) të rajonit më pak të zhvilluar planor në RM		së pakur 35% të mesatares së BE
3	Dallimi i PBB për banorë të rajonit planor më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar	3,6 herë*	Më së shumti 3 herë
4	Kohëzgjatja e pritur e jetës gjatë lindjes	73.4 vjeç*	75 vjeç
5	Rritja e popullatës në rajonet në lidhje me rritjen e popullatës në RM		
	Rajoni me rritjen më të madhe në krahasim me rritjen e RM	3,96%***	2%****
	Rajoni me rritjen më të vogël në krahasim me rritjen e RM	RM -5,68%***	-2%****
6	Niveli arsimor i popullatës		
		E ulët 53.1%	35% (ulje për 40% në nivelin rajonal)
		Mesme 36,9%	45% (rritje për 20% në nivelin rajonal)
		E lartë 10%	20% (rritje për 100% në nivelin rajonal)
7	Numri i të papunëve	341,893**	250.000 (ulje për 30% në nivelin rajonal)

* 2007 vit; **shtator 2009 ; *** 1994 – 2002 ; ****2002 – 2012

Burimi: Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2010-2012.

Në planin e dytë të veprimit gjejmë tabelë të ngjashme me titullin e njëjtë, por me strukturë të ndryshme.³¹ Të dhënat nga tabela e dytë janë përditësuar dhe në krahasim me të dhënat nga tabela e parë, tregojnë efekte më konkrete në krahasim më vlerat e projektuar për vitin 2019, veçanërisht në dy prej shtatë synimeve: Dallimi i PBB për banorë të rajonit planor më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar dhe numri i të papunëve. Nga të dhënat e prezantuar në planet e veprimit vërehet një përparim modest ndaj realizimit të synimeve të caktuara, megjithatë ende mbetet një hapësirë e madhe për përmirësim në fushën e: zvogëlimit të papunësisë, dallimi në PBB për kokë banor në krahasim me BE dhe mes rajoneve, rritja e popullatës në rajonet dhe kohëzgjatja e pritur e jetës.

Tabela 19: Tregues të vlerësimit të efekteve (ndikimeve) nga zbatimi i Strategjisë 2009 - 2019

	Tregues	3269 euro	3434 euro	3630 euro	2019 Vlerë
1	PBB mesatar rajonal për banorë në Republikën e Maqedonisë	1527 euro	1606 euro	1718 euro	së pakur 50% të mesatares së BE
2	PBB për banorë të rajonit më pak të zhvilluar planor në RM	3,32 herë	3,18 herë	3,04 herë	së pakur 35% të mesatares së BE
3	Dallimi i PBB për banorë të rajonit planor më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar	341.295***	321.341****	281.341*****	Më së shumti 3 herë
7	Numri i të papunëve	341.295***	321.341****	281.341*****	250.000 (ulje për 30% në nivelin rajonal)

*** dhjetor 2009; **** dhjetor 2010; ***** dhjetor 2011

Burimi: Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2012-2015.

Në tabelën vijuese prezantohen të dhënat prej të cilave fitohet përshtypja që mjetet e parashikuara për zbatimin e politikës për ZHBR gradualisht zhduken gjatë procesit të menaxhimit publik financiar gjatë “alokimit”, “aprovimit” dhe “pagesës” së mjeteve nga Buxheti i RM-së nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale. Ashtu, për shembull, mesatarja në përpjesëtimin e mjeteve të planifikuara për alokim dhe mjete të alokuara nga Buxheti i RM për realizimin nëpërmjet MVL në periudhën 2009-2012 është vetëm 45%, ndërsa mesatarja në këto tre vite të përdorimit të mjeteve në lidhje me

31 Plani Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013, fq. 23

mjetet e planifikuara në Planin e Veprimit 2009-2012 është më i ultë dhe është madje edhe më pak 1/3 (29%). Në këtë kontekst nuk është theksuar edhe një informacion kyç – çfarë përqindje përfaqësojnë këto mjete në krahasim me PBB të plotë të shtetit në 2009-2012 dhe në fund sa dallon kjo përqindje në krahasim me obligimin e përcaktuar në Nenin 27, Paragrafin 2 të Ligjit për Zhvillim të Barabartë Rajonal, në të cilën shkruhet: “Për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vit ndahen mjete në lartësi prej së paku 1% të PBB”.

Tabela 20: Tregues për vlerësim të efekteve dhe rezultateve të zbatimit të masave nga Plani i Veprimit në periudhën 2010-2012³²

Tregues	2010	2011	2012
	në milion denarë		
Mjete të alokuara nga Buxheti i RM që planifikohen të realizohen nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale	333,52	451,08	473,64
Mjete të aprovuara (të planifikuara për vitin 2012) nga Buxheti i RM për realizim nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale	246	202,29	77,4
Proporcioni i alokimit të planifikuara dhe mjete të alokuara nga Buxheti i RM për realizim nëpërmjet MVL	73,8%	44,8%	16,3%
Mjete të paguara nga Buxheti i RM të realizuar nëpërmjet MVL	138,8	140,6	67,3
Shfrytëzimi i mjeteve të alokuara nga Buxheti i RM për realizim nëpërmjet MVL	56,4%	69,4%	87%
Shfrytëzimi i mjeteve në krahasim me mjetet e planifikuara në Planin e Veprimit 2009-2012	41,6%	31,1%	14,2%

Burimi: Plan Veprimi për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2012-2015.

Në lidhje me realizimin e vlerave të planifikuara të indeksit zhvillimor për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore në planin e dytë të veprimit janë prezantuar të dhëna që tregojnë se vlerat e planifikuara të zhvillimit në rajonet në vitin janë realizuar diku në vitin 2012, në pjesën më të madhe të rajoneve.³³

³² Plani Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013, fq.25

³³ Plani Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013, fq. 26

Tabela 21: Vlera të planifikuara dhe realizuara të indeksit zhvillimor në rajonet në vitin 2012

Rajoni planor	2008	2012 i planifikuar	2012 i realizuar
Shkupit	1,48	1,62	1,51
Juglindor	0,89	1,03	0,97
Pellagonisë	0,73	0,80	0,91
Jugperëndimor	0,72	0,74	0,81
Pollogu	0,72	0,75	0,82
Vardari	0,69	0,75	0,73
Lindor	0,67	0,72	0,96
Verilindor	0,56	0,60	0,63

Burimi: Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2012-2015.

Në planin e fundit të veprimit ju prezantojmë disa të dhëna të lidhur me treguesit dhe realizimin e tyre.

Tabela nr. 22 ka shumë të dhëna më të hollësishme për realizimin e shtatë treguesve kryesor për zbatimin e strategjisë për ZHBR deri në vitin 2019 në krahasim me tabelat paraprake me treguesit e njëjtë në dy planet e veprimit.

Sipas treguesit të parë, PBB mesatar për banor në Republikën e Maqedonisë (sipas PKM), ka regjistruar përparim, por me siguri i pamjaftueshëm për të realizuar synimin prej së paku 50% nga mesatarja e BE-së i parashikuar në strategjinë prej 2009. Por, duke marrë parasysh që në vitin 2014 kjo strategji ishte ndryshuar dhe synimi ishte zvogëluar në 42% nga mesatarja e BE-së, ka mundësi nëse shteti në vitet vijuese arrin një rritje të qetë të PBB, që të mund të realizohet synimi i përmirësuar.

Synimi i dytë, PBB për banor (sipas PKM) në rajonin planor me pak të zhvilluar në RM të jetë së paku 35% nga mesatarja e BE-së duke e pamundshme për të realizuar, sepse dy rajonet më pak të zhvilluara (i Pollogut sipas PBB më të ultë për banor dhe Verilindor sipas indeksit zhvillimor) kanë 17.7, gjegjësisht 22.4 për qind nga mesatarja e BE-së. Por, duke marrë parasysh që në strategjinë e rishqyrtuar parashikohet që rajoni më pak i zhvilluar planor të ketë PBB për banor prej 26% nga mesatarja e BE në vitin 2019, ka mundësi që edhe ky synim i ndryshuar të arrihet.

Synimi i tretë, dallimi në PBB për banorë në rajonin planor më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar të jetë më së shumti tre herë, vetëm më është realizuar në vitin 2013, ndonëse me strategjinë e rishqyrtuar në vitin 2014 ky dallim është zvogëluar për 2.2 herë, që duket tepër ambicioz, duke marrë parasysh të dhënat e prezantuar në tabelat më lartë, dhe që tregojnë që rajoni më pak i zhvilluar,

Verilindor, edhe më tutje vazhdon të ngec në krahasim me pjesën më të madhe të rajoneve në kuptim të gjitha parametrave.

Për synimin e katër nuk ka të dhëna për rajone, por vetëm për mesataren kombëtare për kohëzgjatje të pritur të jetës.

Në lidhje me synimin e pestë (ritja e popullatës në rajonet në krahasim me rrojtëm e popullatës në RM) janë prezantuar të dhëna nga vitet 2009 dhe 2013 prej të cilave fitohet një përshtypje që situata demografike fillon të stabilizohet, pa lëvizje të mëdha në rritjen ose uljen e popullatës në rajone të caktuara, siç ka qenë rasti në vitin 2009. Në vitin 2013, rritje më të madhe në krahasim me mesataren e shtetit është vërejtur në rajonin e Shkupit, me 1.63% rritje më të madhe në krahasim me rritjen shtetërore. Ulje më të madhe të popullsisë në vitin e njëjtë është vërejtur në Rajonin Lindor, kur ka pasur 1.85 përqindje rritje më të ulët nga popullata në krahasim me atë shtetëror. Nëse fillohet me këtë rritje të rajoneve, mund që në vitin 2019 të realizohet situata e preferuar prej maksimum 2% dallim në rritjen e popullatës nëpër rajone në krahasim me mesataren shtetërore.

Ngjashëm me këtë, edhe në synimin e gjashtë dhe të shtatë (niveli arsimor i popullatës së aftë për punë dhe numri i të papunëve) të dhënat e prezantuar në planin më të ri të veprimit për zbatim të strategjisë për ZHBR 2009-2019 tregojnë lëvizje pozitive, ndonëse edhe këtu, njëlloj sikur në synimin e katërt, të dhënat e prezantuar janë vetëm për mesataren kombëtare.

Tabela 22: Tregues të vlerësimit të efekteve (ndikimeve) nga zbatimi i Strategjisë 2009 - 2019³⁴

Tregues	2007	2009	2013	2019 Vlerë
1 PBB mesatar rajonal për banorë në Republikën e Maqedonisë (sipas PKM)	7.512€ (30% nga mesatarja e BE 27)	8.424€ (35% nga mesatarja e BE 27)	9.500€ (36% nga mesatarja e BE 28)	së pakur 50% të mesatares së BE

2	PBB për banorë (sipas PKM) të rajonit më pak të zhvilluar planor në RM	3.571€	3.952€	4.636€ (Rajoni i Pollogut si rajoni planor me PBB më të ultë është 17.7% nga mesatarja e BE 28) 5.918€ (Rajoni Verilindor si rajoni më dobët i zhvilluar planor është 22.4% nga mesatarja e BE 28)	Së paku 35% të mesatares së BE
3	Dallimi i PBB për banorë të rajonit planor më të zhvilluar dhe më pak të zhvilluar	3,47 herë	3,32 herë	2,94 herë	Më së shumti 3 herë
4	Kohëzgjatja e pritur e jetës gjatë lindjes	73,4 vjeç	74,7 vjeç	Gjithsej 74,98 77,05 Gra* 72,97 Burra	80 vjeç gra 75 vjeç burra
5	Rritja e popullatës në rajonet në lidhje me rritjen e popullatës në RM				
	Rajoni me rritjen më të madhe (dallimi në krahasim me rritjen e RM)	/	3,96%	1,63%** (Rajoni Planor i Shkupit)	2%
	Rajoni me rritjen më të vogël (dallimi në krahasim me rritjen e RM)	/	-5,68%	-1,85%** (Rajoni Planor Lindor)	-2%

6	Niveli arsimor i popullatës së aftë për punë					
		Të ulët	/	53,1%	38,92%***	35% (ulje për 40%)
		Të mesme	/	36,9%	46,11%***	45% (ritje për 20%)
		Të lartë	/	10%	14,97%***	20% (ritje për 100%)
7	Numri i personave të papunë (dhe personave tjerë që kërkojnë punë)	341.893****	272.392*****	223.808*****	250.000 (ulje për 30%)	

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës:

*2010 **2010 në krahasim me 2014 ***2014

Burimi: Enti për Punësim i RM

**** shtator 2009 ***** prill 2012 ***** dhjetor 2014

Në tabelat vijuese nr. 23 dhe 24 janë prezantuar të dhëna për mjetet e parashikuar për zbatimin e politikës për ZHBR nga momenti kur janë planifikuar me plane veprimi trevjeçare ose me programet për zhvillim të barabartë ekonomik deri në momentin kur janë realizuar nga Buxheti i RM nëpërmjet Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale ose Byrosë për Zhvillim Rajonal. Gjithashtu, këtu konfirmohet teza për menaxhimin joefikas publik financiar dhe “humbjen/uljen” e mjeteve në procesin e planifikimit dhe realizimit të tyre, mirëpo nëse krahasohet indikatorin e mjeteve të paguara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të realizuar nëpërmjet MVL dhe Byrosë në krahasim me ato të planifikuarat në planet e veprimi mund të vërehet që kjo përqindje në periudhën 2013-2015 është rritur dhe paraqet 53% në krahasim me periudhën 2009-2012 kur e njëjta ka qenë vetëm 29%. Një përshtypje pozitive jep rritja e mjeteve të planifikuara për këtë qëllim në vitet 2016, 2017 dhe 2018 për të cilën jepet vlerësim pozitiv edhe në raportin më të ri të progresit nga BE për Maqedoninë, por ka një punësi duke marrë parasysh trendet paraprake që deri në momentin e realizimit të këtyre mjeteve mund të “zhduken” në rebalancin e buxheteve, në “alokimet”, “aprovimet” dhe “pagesat”.

Tabela 23: Tregues për vlerësim të efekteve dhe rezultateve të zbatimit të masave nga Plani i Veprimit në periudhën 2013-2015

Të realizuar (në milion denarë)

Tregues	2013	2014	2015
Mjete të planifikuar në MVL dhe BZHR me Planin e Veprimit 2013-2015	99,4	206,5	227,2
Mjete të planifikuar në MVL dhe Byronë me Programet për Zhvillim të Barabartë Rajonal vjetor	99,41	117,11	147,71
Mjete të paguara nga Buxheti i RM të realizuar nëpërmjet MVL dhe Byrosë	50,91	112,33	123,56

Tabela 24: Tregues për vlerësim të efekteve dhe rezultateve të zbatimit të masave nga Plani i Veprimit në periudhën 2016-2018

Të planifikuar

Tregues ³⁵	2016	2017	2018
	në milion denarë		
1 Mjete të alokuara nga Buxheti i RM që do të realizohen nëpërmjet MVL dhe Byrosë për zhvillim rajonal	570,17	870,17	980,98
Shfrytëzimi i mjeteve të alokuar nga Buxheti i RM për realizim nëpërmjet MVL	90%	90%	95%
2 Mjete të alokuara nga Buxheti i RM që do të realizohen nëpërmjet ministrive tjera**	17.157,88	19.509,71**	19.962,42***
Shfrytëzimi i mjeteve të alokuar nga Buxheti i RM për realizim nëpërmjet ministrive tjera	70%	75%	80%

35 "Mjetet financiare të theksuar në tabelën, dhe alokuar në buxhetet e institucioneve jashtë MVL, do të përdoren në përputhje me procedurat e institucioneve përkatëse. Megjithatë, duke marrë parasysh madhësinë e këtyre mjeteve, domethënia e tyre për zhvillimin rajonal në Maqedoni, si dhe nevojë për përdorimin e tyre si shtytës së zhvillimit të barabartë, duhet të shfaqen edhe në mënyrë përmbledhëse, gjegjësisht të monitorohet shfrytëzimi i tyre si parametra hyrës në gjithë sistemin e mbështetjes financiare të zhvillimit rajonal në Maqedoni (pa dallim nëse mjetet janë alokuar në MVL ose ndonjë institucion tjetër)." Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2016-2018, Gazeta Zyrtare e RM 123/2016, fq. 22

“Në tabelën janë prezantuar mjetet e programeve vijuese: Programi OA Zhvillimi i Barabartë Rajonal, MB, bashkëpunimi ndërkufitar që janë përjashtuar nga paragrafi 420 – mallra dhe shërbime nga buxheti themelor dhe 4A Sheshi

**Mjetet e alokuara në IPA dhe IPA2 relevante për zhvillimin rajonal janë shfaqur në mënyrë të drejtë në buxhetet e institucioneve që janë përgjegjëse për menaxhimin e tyre, ndërsadaln nga Buxheti i RM për 2016.

Ministritë nuk janë të kyçur në mjetet e planifikuara me programe me komponentë zhvillimore për vitet 2017 dhe 2018 sepse nuk ka të dhëna.

Në planin e veprimit të fundit janë prezantuar edhe qëllime të reja për indeksin zhvillimor, ekonomik-social dhe demografik për gjitha rajonet në vitin 2018, sipas të cilëve pritet që katër prej tetë rajoneve të tejkalojnë indeksin mesatar zhvillimor në nivel të Maqedonisë dhe që rajoni i Shkupit do të mbetet në vlerën e njëjtë për këtë indeks. Në këto projekte, mbrapsje të vetme do të vërehen në indeksin demografik, në vlerat e Rajonit të Shkupit dhe Pellagonisë. Për gjitha parametrat tjera, pritet që rajonet të arrijnë përparim (shikoni tabelën nr. 25).

Tabela 25. Tregues të lidhur me indeksin për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve planore

Indeksi zhvillimor				
Rajoni planor	2008	2012 i planifikuar	2012 i realizuar	2018
Shkupi	1,48	1,62	1,51	1,51
Juglindor	0,89	1,03	0,97	1,10
Pellagonisë	0,73	0,80	0,91	1,05
Jugperëndimor	0,72	0,74	0,81	0,92
Pollogu	0,72	0,75	0,82	0,93
Vardari	0,69	0,75	0,73	0,85
Lindor	0,67	0,72	0,96	1,08
Verilindor	0,56	0,60	0,63	0,80

Indeksi ekonomik-social				
Rajoni planor	2008	2012 i planifikuar	2012 i realizuar	2018
Shkupi	1,86	1,95	1,48	1,50
Juglindor	1,38	1,45	1,29	1,35
Pellagonisë	0,79	0,87	1,09	1,15
Jugperëndimor	0,5	0,58	0,98	1,05
Pollogu	0,18	0,20	0,50	0,70
Vardari	0,63	0,72	0,70	0,84
Lindor	0,95	1,05	1,36	1,40
Verilindor	0,33	0,38	0,27	0,40
Indeksi demografik				
Rajoni planor	2008	2012 i planifikuar	2012 i realizuar	2018
Shkupi	1,25	1,29	1,53	1,50
Juglindor	0,58	0,62	0,72	0,80
Pellagonisë	0,69	0,74	0,80	0,65
Jugperëndimor	0,86	0,90	0,70	0,70
Pollogu	1,05	1,08	1,07	1,10
Vardari	0,73	0,78	0,76	0,85
Lindor	0,5	0,54	0,65	0,70
Verilindor	0,7	0,75	0,90	1,05

36 Revizioni i nivelit të suksesit – efektiviteti i zbatimit të Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal, raporti final i revizorit të autorizuar shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit, 2013

37“Efekti i të dhënave jo të përditësuar ka ndikim mbi përqindjen e shpërndarjes së mjeteve sipas rajoneve, për periudhën vijuese.” (Revizioni i nivelit të suksesit – efektiviteti i zbatimit të Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal, raporti final i revizorit të autorizuar shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit, 2013)


KORNIZA 3: REVIZIONI I REALIZIMIT TË PROGRAMIT PËR ZHBR NGA ANA E ENTIT PËR REVIZION


Gjatë vitit 2012, (nga shtatori deri në dhjetor) Enti i Revizionit të RM-së ka zbatuar revizion të nivelit të suksesit që ka të bëjë me aktivitetet e lidhura me vlerësimin e rreziqeve dhe mundësi për përmirësim të efikasitetit të realizimit të Programit për ZHBR. Periudha që ishte e përfshirë me revizionin është 2009-2012. Në revizionin e tyre kanë theksuar disa fusha të rrezikshme:

- Rregullorja ligjore për ZHBR;
- Financimi i ZHBR (mjete të planifikuar dhe realizuara për ZHB në Buxhetin e RM për periudhën 2009-2012);
- Zgjedhje të propozim-projekteve dhe financimi i tyre, dhe
- Monitorim të shfrytëzimit të mjeteve të përcaktuar për ZHBR.

Disa prej zbulimeve më të rëndësishme janë⁶:

- Kjo fushë është rregulluar me rregullore nënligjore, që miratohet me vonesë prej një deri katër vite,
- Mospërputhje në zbatimin e ligjit, sepse në praktikë paraqiten dallime në mënyrën dhe organin nëpërmjet të cilit transmetohen mjetet nga Buxheti i RM për financim të projekteve planore
- Nuk është vendosur një sistem informativ që duhet të përmbajë të dhëna të përditësuar dhe besueshme në lidhje me shkallën e zhvillimit sipas rajoneve, prej të cilëve varet shpërndarja procentuale e mjeteve të Buxhetit të RM sipas rajoneve për ZHBR.⁷
- Ka një tendencë të uljes së mjeteve që ndahet nga Buxheti i RM për ZHBR
- Financim retroaktiv të projekteve për ZHB (miratohen vendime nga Qeveria për shpërndarje të mjeteve për financim të projekteve në fund të vitit, siç është rasti me vitet 2009 dhe 2012, për projekte që kanë qenë të aprovuar vitin paraprak.
- Nivel jashtëzakonisht të ultë të mjeteve të ndara për ZHBR. Pjesëmarrja në përqindje të mjeteve të ndara nga Buxheti i RM për ZHBR, në krahasim me PBB për periudhën 2009-2011 lëviz mes 0.03 dhe 02% në vend që të jetë në shumë prej së paku 1% të PBB
- Është përcaktuar rrezik në punën e Komisionit për Vlerësim të Propozim Projekteve për ZHBR. Mungesa e dispozitave të sakta ligjore për mënyrën e punës së komisioni dhe e drejta e përcaktuar diskrecioni në ligjin për Ministrin e VL për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit mund të kenë ndikim mbi zgjedhjen e projekteve dhe kontributi i tyre për ZHB
- Për shkak të shumës së pamjaftueshme të mjeteve që ndahen nga Buxheti i RM për zhvillim rajonal, si dhe trendi i zvogëlimit të mjeteve të planifikuar me rebalancin e buxhetit, nuk është arritur efektiviteti i mjaftueshëm i realizimit të Programit për ZHBR.





REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Siç mund të vërehet nga të dhënat e institucioneve zyrtare shtetërore të prezantuar më lartë, politika për zhvillim të barabartë rajonal përballohet me sfida serioze dhe për atë e pret një punë serioze në të ardhmen. Ka arritur përparim të vogël, një pjesë e rajoneve kanë shënuar trendë pozitive në lidhje me parametrat ekonomike, por, siç vëren edhe Enti për Revizion në analizat e suksesit të kësaj politike, “nuk është arritur efektivitet i kënaqshëm nga realizimi i Programit për ZHBR”. Të pakënaqshme janë edhe të dhënat që tregojnë se mbi gjysma e investimeve vazhdojnë të gjenerohen në rajonin më të zhvilluar, rritja natyrore në pjesën më të madhe të rajoneve është negative, ndërsa tre rajonet më pak të zhvilluara (Verilindor, Pollogu dhe Jugperëndimor) përballohen me papunësi më të madhe dhe në vitet e fundit nuk kanë përmirësim të dukshëm të PBB në krahasim me rajonet tjera të shtetit.


Zgjidhja ligjore për ndarje të 1% të PBB për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vit, Qeveria e interpreton në mënyrë që i orienton gjitha alokimet buxhetore nga ministritë e ndryshme dhe agjencitë që kanë ndonjë lidhje me fushën e zhvillimit rajonal, por jo konkretisht me zhvillimin e barabartë rajonal. Për të qenë zhvillimi rajonal i barabartë, duhet të ndiqet metodologjia aktuale ose të propozohet metodologji e re për ndarje të mjeteve buxhetore, sipas të cilës, mjetet në shumë prej 1% të PBB (ose 3.25% siç thekson Qeveria në një prej dokumenteve të saja) do të ndahen sipas proporcionit përkatës që del nga shkalla e zhvillimit të secilit prej rajoneve planore.

Ka nevojë që me anë të Këshillit për Zhvillim të Barabartë Rajonal ose Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale në afatin më të shpejtë të themelohet një sistem transparent të njoftimit të gjitha parametrave të zhvillimit të rajoneve, me të cilin do të ndihmohet të rritet interesi dhe vetëdija e qytetarëve për këtë politikë të rëndësishme për të ardhmen e shtetit. Në vetë Strategjinë për Zhvillim Rajonal 2009-2019 është përmendur një sistem informativ që do të mundësojë respektimin e drejtë të parimeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë gjatë zbatimit të Strategjisë, si dhe gjatë sigurimit të qasjes në informacione me karakter publik lidhur me zbatimin e Strategjisë.

Duke marrë parasysh që politika për zhvillim të barabartë rajonal është në përputhje me qëllimet strategjike të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në BE, si dhe në përputhje me drejtimit për zhvillim të decentralizimit të parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, autorët e kësaj analize konsiderojnë që duhet një konsensus mes faktorëve kryesor politik të vendit për zbatim të mëtutjeshme dhe konsiderueshme të ligjit për ZHBR. Pas një dekade të plotë të ligjit dhe strategjisë, pa asnjë përparim të dukshëm në lidhje me vetëdijen e popullatës dhe shoqërisë dhe në lidhje me vullnetin politik, duke sikur ajo nuk ekziston aspak. Ndonëse ka vullnet më të madh dhe dedikim nga ana e strukturave udhëheqëse të institucioneve relevante (autoriteteve) për ngritjen e kapaciteteve të zhvillimit rajonal, mund të shqyrtohet mundësia e një ministrie të veçantë për zhvillim rajonal, siç ka në Bullgari (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Çështje Publike), Kroaci (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Fonde të BE-së), Çeki (Ministria e Zhvillimit Rajonal), Rumani (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Administratë Publike), Poloni (Ministria e Zhvillimit Rajonal që në vitin 2031 ishte ri-emëruar në Ministria e Infrastrukturës dhe Zhvillimit), Latvi (Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zhvillimit Rajonal), Ukrainë (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ndërtimtari), Moldavia (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ndërtimtari), Xhorxhi (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Infrastrukturë), ose Norvegji (Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Zhvillimit Rajonal).

LITERATURA E PËRDORUR

- Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2012-2015, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, mars 2010.
- Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2013-2015, Gazeta Zyrtare e RM 122/2013
- Plani Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim të Barabartë në Maqedoni 2016-2018, Gazeta Zyrtare e RM 123/2016
- Enti Shtetëror i Statistikës, Regjistrimi i Popullsisë, amvisërive dhe vendbanimeve, 2002
- Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal, teksti i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 63/2007, 187/2013, 43/2014 и 215/2015)
- Maqedonia në Numra 2014, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2014
- Maqedonia në Numra 2015, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2015
- Maqedonia në Numra 2016, Enti Shtetëror i Statistikës, qershor 2016
- Plani Zhvillimor Kombëtar 2007-2009, Qeveria e RM, Shkup, shkurt 2007
- Vendim për shpërndarjen e mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore në vitin 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 86/2016
- Vendimi për klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit të rajoneve të planifikimit për periudhën 2013-2017, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr.88/2013
- Rajonet Planore në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale 2011
- Revizioni i nivelit të suksesit – efektiviteti i zbatimit të Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal, raporti final i revizorit të autorizuar shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit, 2013
- Rajonet në Republikën e Maqedonisë, Enti Shtetëror i Statistikës 2016
- Mbrojtja Sociale e Fëmijëve, të Rinjve dhe të Rriturve në Republikën e Maqedonisë, 2015, Enti Shtetëror i Statistikës, tetor 2016
- Shkalla e Zhvillimit dhe Klasifikimi i Rajoneve Planore (elaborat i ekspertëve), Vlabor, Shkup, maj 2013
- Strategjia për Ndryshimin dhe Plotësimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, shtator 2014.
- Strategjia për Zhvillim Rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019, “Gazeta Zyrtare e RM, nr. 119/2009
- The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report, Brussels, 9.11.2016, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf



Publisher: Foundation Open Society – Macedonia

For the publisher: Fani Karanfilova – Panovska

Authors: Slagjan Penev and Borce Trenovski

Proofreading into Macedonian: Abakus

Translation into English: Abakus

Translation into Albanian: Abakus

Design: Koma

Print: Datapons

Circulation: 300 copies

Free-of-charge/non-commercial circulation

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
352.072.2(497.7)

